Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

TË ARRITURAT KRYESORE TË QEVERISË KURTI 2

2021
2026

Bilanci i mandatit qeverisës dhe konsolidimi i shtetit demokratik

Kryeministri Albin Kurti

Prishtinë · 2026

Nga 7 në 11.4 miliardë euro

vlera e përgjithshme e ekonomisë së vendit

Nga 25.8% në 10.8%

rënia e shkallës së papunësisë, me punësim të ri dhe formalizim të tregut të punës

Nga 130/170 euro në 500 euro

paga minimale e ligjshme, prej 1 korrikut 2026

> *"Prekëm çdo shtresë e çdo qytetar në çdo cep të republikës."*
>
> Albin Kurti, ekspozeja në Kuvend, 26 tetor 2025

FJALA HYRËSE

Të dashur qytetarë,

Kur morëm detyrën dhe besimin tuaj në mars të vitit 2021, Kosova po përballej me ethet e pandemisë Covid-19, një pandemi që ndodh një herë në shekull. Në atë pikënisje, trashëguam një ekonomi të bllokuar dhe institucione të kapura. Pandeminë e menaxhuam duke siguruar vaksinat dhe duke vaksinuar shumicën e qytetarëve në afat rekord. Kjo mundësoi rihapjen e ekonomisë dhe rritjen e vrullshme të saj.

Por rrugëtimi ynë nuk ishte i lehtë. Pa kaluar as një vit, na goditi kriza energjetike dhe rritja e kostos së jetesës si pasojë e luftës në Ukrainë, krizë të cilën kontinenti evropian nuk e kishte parë brenda gjysmëshekullit të fundit. E sikur të mos mjaftonin këto sfida globale, përgjatë mandatit u përballëm edhe me sulmet më të rënda në vendin tonë që nga shpallja e pavarësisë, në Banjskë dhe në kanalin Ibër-Lepenc.

Megjithëkëto, ne ia dolëm: Qeveria Kurti 2 u bë qeveria e parë në Kosovë që e çoi mandatin deri në fund. Që nga dita jonë e parë, zotimi ynë ka qenë i palëkundur për një model të ri qeverisjeje: transparent, të drejtë dhe llogaridhënës.

Në përmbushje të këtij zotimi, kjo përmbledhje nuk vjen si një fjalim politik për premtime, por si pasqyrim i punës sonë. Në njëzet e gjashtë fusha të qeverisjes, të ndara në gjashtë kapituj kryesorë, kemi rreshtuar faktet: gjendjen që trashëguam dhe progresin që realizuam. Këto nuk janë shifra tona; janë të dhëna të matshme dhe të verifikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, ministritë e linjës dhe institucionet ndërkombëtare që na vëzhgojnë.

Ndonëse rrugëtimi ynë u vështirësua nga bllokimi paszgjedhor në Kuvend, edhe si qeveri në detyrë ne nuk devijuam asnjëherë nga misioni. Besojmë fuqishëm se rritja ekonomike nuk është thjesht një statistikë në letër. Ajo ka vlerë vetëm kur ndjehet në jetën tuaj: te paga që rritet, te shtesat për çdo fëmijë, te punësimi pa ndërmjetës dhe te sovraniteti në çdo cep të territorit tonë.



Para jush është bilanci i pesë viteve punë dhe përkushtim mbarëpopullor. Gjykimi, si gjithmonë, ju takon juve.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

PËRMBAJTJA

KAPITULLI 1 · EKONOMI

01	Indikatorët kryesorë ekonomikë	8
02	Bujqësia dhe mbështetja për fermerët	10
03	Ringritja e ndërmarrjeve publike	11
04	Energjia, inovacioni dhe teknologjia	13
05	Mjedisi, planifikimi hapësinor dhe infrastruktura	15
06	Industria, ndërmarrësia, tregtia dhe inovacioni	17

KAPITULLI 2 · SOCIALE

07	Arsimi	20
08	Modernizimi i sistemit shëndetësor	22
09	Kultura, sporti dhe trashëgimia	24
10	Mirëqenia dhe mbështetja sociale	27
11	Gratë, fuqizimi ekonomik dhe barazia	29
12	Rinia dhe punësimi meritokratik	31

KAPITULLI 3 · SIGURI

13	Mbrojtja dhe ushtria	33
14	Sundimi i ligjit, luftimi i korrupsionit dhe siguria kombëtare	35
15	Konsolidimi i sistemit të drejtësisë	37
16	Shtrirja e ligjshmërisë në veri	39

PËRMBAJTJA *(vazhdim)*

KAPITULLI 4 · LOKALE

17 Fuqizimi i komunave 41

18 Mbështetja për komunitetet joshumicë 42

19 Digjitalizimi i shërbimeve 43

20 Reforma e administratës publike 45

KAPITULLI 5 · KOMBËTARE

21 Mbështetja për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin 47

22 Integrimi strategjik Kosovë–Shqipëri 48

23 Mërgata dhe përfshirja e saj në zhvillim 50

KAPITULLI 6 · NDËRKOMBËTARE

24 Progresi drejt Bashkimit Evropian 53

25 Politika e jashtme dhe anëtarësimet 54

26 Lartësimi i imazhit ndërkombëtar 56

KOSOVA SOT

Gjashtë shtylla të progresit, tetë shifra të së vërtetës.

— 1 · EKONOMI

25 mld €

Qarkullimi i bizneseve

u dyfishua pa borxhe të reja.

— 1 · EKONOMI

50% dhe 75%

Rritja e pagës mesatare

në sektorin publik dhe atë privat.

— 2 · SOCIALE

1.3 mld €

Rishpërndarje direkte

me shtesa e pako mbështetëse për qytetarët dhe familjet.

— 2 · SOCIALE

Pesëfish

Ulje e pabarazisë së pagave

në administratën shtetërore, nga 20:1 në 5:1.

— 3 · SIGURI

167

Banda kriminale

të shkatërruara nga Policia në tërë territorin.

— 4 · LOKALE

62

Struktura ilegale

të Serbisë të mbyllura përgjithmonë.

— 5 · KOMBËTARE

4 mil €

Linja për Luginën

me buxhetim vjetor për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin.

— 6 · NDËRKOMBËTARE

35 nga 38

Fushat me progres

të vlerësuar nga raporti i BE-së për vendin tonë.

KAPITULLI I PARË

EKONOMI

Zhvillimi, prodhimi, energjia dhe infrastruktura. Gjendja që trashëguam dhe progresi që realizuam.

01	Indikatorët kryesorë ekonomikë	8
02	Bujqësia dhe mbështetja për fermerët	10
03	Ringritja e ndërmarrjeve publike	11
04	Energjia, inovacioni dhe teknologjia	13
05	Mjedisi, planifikimi hapësinor dhe infrastruktura	15
06	Industria, ndërmarrësia, tregtia dhe inovacioni	17

01 Indikatorët kryesorë ekonomikë

11.4 mld € Brutoprodukti Vendor (BPV) në vitin 2025.


3.3 mld €
të hyra buxhetore

433 mijë
vende aktive pune, rritje për 17.6% nga viti 2021 (368 mijë)

700 mil € grante
nga bashkësia ndërkombëtare për 4 vjet



- **Cilësia e rritjes:** Rritja ekonomike ishte mesatarisht **6%** në vit, pa u mbështetur te privatizimet e borxhi.
- **Investimet kapitale:** Ekzekutuam **729 milionë euro** për projekte strategjike në vitin 2025, shuma më e lartë e investimeve publike e buxhetuar ndonjëherë.
- **Rënia e papunësisë:** Ulëm shkallën e përgjithshme të papunësisë në **10.8%**, rënia më e madhe historike e matur nga Agjencia e Statistikave.
- **Konsolidimi fiskal:** Borxhin publik e zbritëm në **16%** të BPV (niveli më i ulët në Evropë) nga 22.4% në vitin 2020.
- **Rritje e qarkullimit dhe fitimit:** Dyfishuam qarkullimin e bizneseve, nga 12.5 miliardë euro në vitin 2019 në **25 miliardë euro** në vitin 2025. Në të njëjtën periudhë, fitimi i korporatave sipas të dhënave tatimore u rrit nga 900 milionë euro sa e gjetëm, në rreth **2.3 miliardë euro**.



Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në Kosovë gjatë vitit 2025 ishte **713 euro**, duke u rritur për **11.6%** krahasuar me vitin 2024. Përderisa paga mesatare mujore neto për një të punësuar me pagë në Kosovë gjatë vitit 2025 ishte **636 euro**, duke u rritur për **15.2%** krahasuar me vitin 2024. Burimi: ASK.

PAGA NETO SIPAS SEKTORËVE, 2024 → 2025

Sektori publik (administrata)	Ndërmarrjet publike	Sektori privat
668 € → 744 € (+11.4%)	685 € → 812 € (+18.5%)	513 € → 596 € (+16.2%)

Gjatë Kurti 2 (pranverë 2021 - pranverë 2026), buxheti i pagave të nëpunësve publikë në administratën shtetërore (pa i përfshirë ndërmarrjet publike) është rritur nga 625 milionë euro në **980 milionë euro**, me një shtim të të punësuarve për rreth tre mijë veta. Pra, paga mesatare është rritur **rreth 50%**.

Në sektorin privat rritja e pagës mesatare në vitin 2025 krahasuar me pesë vjet më parë, sipas të dhënave të ASK-së, është **rreth 75%**, nga 380 euro në **666 euro**.

Niveli i pagës mesatare bruto dhe neto, 2020–2025

në euro, sipas sektorëve. Burimi: ASK

	KOSOVË		SEKTORI PUBLIK		NDËRMARRJET PUBLIKE		SEKTORI PRIVAT	
Viti	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto	Bruto	Neto
2020	**466**	**416**	624	552	769	680	380	342
2021	**484**	**432**	612	542	768	680	419	376
2022	**521**	**446**	604	536	789	659	473	401
2023	**570**	**506**	713	630	789	691	515	459
2024	**639**	**552**	755	668	783	685	598	513
2025	**713**	**636**	**840**	**744**	**915**	**812**	**666**	**596**

- **Pabarazia e pagave:** **Pesëfish** e ulëm pabarazinë e pagave në administratën shtetërore, nga 20:1 në **5:1**.

- **Investime të Huaja Direkte (IHD) rekord:** Gjatë pesëvjeçarit tonë (2021–2026), vlera e përgjithshme e IHD-ve neto në Kosovë arriti në **mbi 4 miliardë euro**, me një mesatare vjetore prej **gati 800 milionë euro**. IHD-të u rritën nga 420.7 milionë euro në vitin 2021 në **1.05 miliardë euro** në vitin 2025 (viti i parë kur tejkaluan një miliard euro), duke shënuar një rritje prej 150.3%.
- **Dyfishim i eksporteve:** Përmirësuam ndjeshëm raportin eksport-import, duke e ngritur nga **1:9 në 1:6.6**.
- **Marrëveshjet me Bankën Botërore:** Në mars 2026, nënshkruam dy marrëveshje në vlerë prej **96 milionë euro**, për forcimin e sektorit financiar dhe lehtësimin e tregtisë në Kosovë.
  - **Projekti për Zhvillimin e Sektorit Financiar (49 milionë euro)** do të mbështesë themelimin dhe funksionalizimin e Bankës Zhvillimore, kapitalizimin e institucioneve kyçe financiare, zgjerimin e instrumenteve të garancisë kreditore për bizneset, si dhe zhvillimin e infrastrukturës moderne të pagesave përmes sistemit të pagesave të shpejta.
  - **Projekti për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor 2.0 (35 milionë euro kredi dhe 12 milionë euro grant)** synon përmirësimin e infrastrukturës dhe procedurave në pikat kufitare, digjitalizimin e proceseve tregtare dhe rritjen e konkurrueshmërisë së tregut, duke e afruar edhe më tej vendin me rrjetet dhe standardet evropiane.





Foto nga nënshkrimi i marrëveshjeve me Bankën Botërore: ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, dhe drejtoresha e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, Xiaoqing Yu, 23 mars 2026, Prishtinë.

02 Bujqësia dhe mbështetja për fermerët

350 mil € grante dhe subvencione direkte për afër 150 mijë fermerë përfitues.

Pagesat direkte për fermerë

milionë euro



Dyfishuam pagesat direkte: **+103%** krahasuar me vitin e fundit para mandatit tonë.

Shifra e vitit 2025, pa përfshirë TM2.

VITET NDËRMJET

2021	28.9
2022	57.5
2023	63.1

Në vitin 2025 përfituan **32,202 fermerë** nga 32,254 aplikime, kundrejt 32,561 aplikimeve në vitin 2024.

- **Vlera e prodhimit:** Prodhimi bujqësor vendor, përfshirë prodhimet bimore dhe blegtorale arriti në rreth **1.19 miliardë euro** në vitin 2025, rritje prej **17.8%** krahasuar me vitin 2024 (rreth 1.01 miliardë euro) dhe rritje prej 52.6% krahasuar me vitin 2020 (rreth 779.5 milionë euro).
- **Eksporti i produkteve bujqësore:** Në vitin 2025 arriti në vlerë prej **186.6 milionë euro**, rreth 152% më shumë se në vitin 2020 kur ishte 73.9 milionë euro.
- **Infrastruktura blegtoriale:** Financuam ndërtimin e **103 shtallave** moderne, me kosto mesatare 50 deri në 80 mijë euro për shtallë, ndërsa deri në vitin 2020 nuk ishte ndërtuar asnjë.
- **Lufta ndaj uzurpimeve:** Kthyem në pronësi të shtetit tokat e tjetërsuara, duke parandaluar një dëm prej **500 milionë eurosh**.

130,310

hektarë të subvencionuar në vitin 2025, rritje për 97% në krahasim me vitin 2021 (66,294 ha të subvencionuar)



Korrja e grurit në Sopi të Suharekës, 4 korrik 2022, ditën kur Kryeministri Kurti dhe ministri Peci shënuan nisjen e korrjeve.

51 mil €

mbështetje nga partneritetet ndërkombëtare, 184% më shumë (në vitet 2018–2021 vetëm 18 milionë euro)

11 mil €

për 5,655 gra fermere në bujqësi përmes subvencioneve dhe granteve

03 Ringritja e ndërmarrjeve publike

mbi 210 mil €

fitim neto i ndërmarrjeve publike qendrore në pesëvjeçarin 2021–2025



- **Disiplina financiare:** Ndalëm kontratat e dëmshme dhe shpenzimet e tepërta operative, si marketingu dhe qiratë e shtrenjta, përmirësuam shërbimet dhe rritëm të hyrat.
- **Gratë në borde:** Përfaqësimi gjinor në bordet e ndërmarrjeve publike qendrore u rrit nga 17% gra para mandatit tonë në **46%** në fillim të vitit 2026.
- **Llogaridhënia dhe auditimi:** Posta e Kosovës dhe Telekomi morën për herë të parë opinionin e pakualifikuar të auditorit, kurse KRU Prishtina kaloi nga opinioni i kualifikuar në atë të pakualifikuar. Rikthyem auditimin nga Zyra Kombëtare e Auditimit: Trepça u audit ua në 2022 pas një dekade, kurse KEK-u, Ibër-Lepenci dhe ujësjellësit Hidrodrini, Mitrovica e Gjakova pas pesë a më shumë vitesh.
- **Korporata e Ruajtjes së Energjisë:** Themeluam **KRE Sh.A.**, një ndërmarrje publike **100%** në pronësi të Republikës së Kosovës, për të menaxhuar dhe operuar investimin strategjik të sistemeve të baterive për ruajtjen e energjisë.

Ndërmarrjet nga afër

Telekomi i Kosovës

23.5 mil € fitim neto 2023–2025, pas 138.5 mil € humbje kumulative deri në 2022

- Modernizoi rrjetin dhe solli për herë të parë teknologjinë 5G në rrjetin e Valës, duke mbuluar mbi 65% të territorit me 5G dhe pjesën tjetër me 4G+, përfshirë për herë të parë katër komunat veriore të vendit.
- Kaloi në kodin shtetëror +383, duke hequr kostot e përdorimit të kodit të Monakos dhe duke siguruar identifikimin ndërkombëtar të Telekomit si operator i Republikës së Kosovës.

KEK

500 mil € investim për modernizimin dhe rehabilitimin e termocentraleve, si dhe për parkun diellor mbi 100MW

- Filloi tenderimin për rehabilitimin dhe modernizimin e njësisë A3 të "Kosovës A", me vlerë mbi 137 milionë €, të financuar nga mjetet vetanake të KEK-ut.
- U rikthye në treg si furnizues, 12 vite pas ndarjes dhe privatizimit të këtij funksioni.

Posta e Kosovës

1.1 mil € fitim neto në vitin 2025, nga 287 mijë euro në vitin 2024

- Këto janë fitimet e para neto që nga ndarja nga Telekomi.
- Hapi 43 zyra të reja postare, 16 prej tyre në veri, dhe investoi me mjete vetanake në motoçikleta elektrike e automjete të reja.

Ibër-Lepenci

4.3 mil € fitim neto në vitet 2022–2025, për herë të parë pas luftës katër vite radhazi me fitim

- Menaxhoi sulmin kinetik në fshatin Varagë të Zubin Potokut më 29 nëntor 2024, me profesionalizëm të lartë dhe riktheu rrjedhën e ujit në kanal brenda 7 orësh dhe furnizimin optimal me ujë për KEK-un brenda 24 orësh, duke shmangur ndërprerjen e prodhimit të energjisë.
- Përfundoi projektin prej 18 milionë € për rehabilitimin e kanalit dhe rezervuarin kompensues prej 30 mijë m³, duke ulur humbjet, përmirësuar cilësinë e ujit dhe siguruar rezerva emergjente për termocentralet ose ujësjellësit.

Trepça

772 parcela me 402 hektarë tokë të rikthyera

- I riktheu parcelat e tokës së Trepçës në të gjithë vendin, përfshirë komunat veriore.
- Unifikoi për herë të parë raportimin e të tri njësive, përfshirë atë në Leposaviq.

Ndërmarrjet nga afër (vazhdim)

KRU Mitrovica

4 komunat veriore ku shtriu shërbimet e veta

- Këto komuna më parë mbuloheshin nga institucione paralele të kontrolluara nga Serbia.
- Për herë të parë pas luftës, ka filluar arkëtimi i pagesave të ujit nga institucionet, ndërsa ka filluar faturimi i bizneseve dhe amvisërive.
- Borxhi paraprak i ujit të papaguar në këto komuna kishte arritur rreth 20 milionë euro.

KRU Bifurkacioni

Përmirësoi humbjet e ujit për 18.5%

- Humbjet e ujit u ulën nga 63.73% në vitin 2020 në 45.22% në vitin 2025.

- **Ujërat e ndotura:** Me investim prej rreth **398 milionë eurosh**, inauguruam impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në Prizren, Pejë dhe Gjakovë, dhe nisëm projektet për Gjilan, Prishtinë, Ferizaj, Podujevë, Mitrovicë e Vushtrri.



Foto nga inaugurimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Ndotura në Gjakovë, 11 maj 2023. Projekt i financuar dhe i realizuar nga Konfederata Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështje Ekonomike (SECO), Republika Federale e Gjermanisë përmes Bankës për Zhvillim KfW, Qeveria e Kosovës dhe Komuna e Gjakovës. Vlera totale e projektit: 16.8 milionë euro.

04 Energjia, inovacioni dhe teknologjia

ENERGJIA

144.14 MW
kapacitete të reja prodhuese tashmë në rrjet

+35 MW
nga modernizimi i turbinës B2 të Termocentralit "Kosova B"

+70 MW
nga parku i erës në Zatriq

+39.14 MW
nga vetë-konsumatorët

Projektet në zhvillim

475 MW + 50 MWth në zhvillim e sipër

Bateritë
170 MW
marrëveshja me MCC, 236.7 mil $
Financimi · Dizajni i projektit · Tenderimi · Shpallja e fituesit · Ndërtimi

Ankandi solar
105 MW
48.88 € për MWh
Dokumentacioni · Shpallja · Pranimi i dy ofertave · Shpallja e fituesit · Ndërtimi

Ankandi i erës
100 MW
Dokumentacioni · Shpallja · Pranimi i dy ofertave · Shpallja e fituesit · Ndërtimi

Parku solar i KEK-ut
100 MW
Sigurimi i financimit për KEK · Përgatitja dhe dizajnimi · Tenderimi · Ndërtimi

Ngrohja qendrore për Prishtinën
50 MWth
Sigurimi i financimit për Termokos · Përgatitja dhe dizajnimi · Tenderimi · Ndërtimi

● e përfunduar ○ në proces ● në vijim

Investimi në kapacitetet ekzistuese për prodhim të energjisë

Modernizimi i turbinave të Termocentralit "Kosova B"

57.87 mil € investimi më i madh në këtë sektor në mbi 40 vite

- **Turbina e njësisë B2, e përfunduar:** +35 MW kapacitet prodhimi, +20 vite jetëgjatësi e njësisë dhe 12% më pak qymyr, nga 1.3 në 1.15 ton për MWh.
- **Turbina e njësisë B1:** modernizimi është në proces.

Ndërtimi i rezervuarit të Ibër-Lepencit

rreth 2.1 mil € 30 mijë m³ ujë

Siguron rezerva emergjente për 24 orë furnizim të termocentraleve të KEK-ut ose të fabrikave të ujit. Pjesë e projektit prej 18 milionë eurosh për rehabilitimin e kanalit kryesor.



Modernizimi i turbinës së njësisë B1 në Termocentralin "Kosova B".



Ndërtimi i rezervuarit të Ibër-Lepencit.

ENERGJIA

Drejtësia dhe përballueshmëria e energjisë

- **Përfundimi i padrejtësisë 24-vjeçare:** Liruam qytetarët e pjesës tjetër të vendit nga barra e mospagesës së energjisë në 4 komunat veriore, me kosto **348 milionë euro** që nga paslufta.
- **Subvencionimi i faturave të energjisë:** Ndamë **120 milionë euro** për të evituar rritjen e çmimit për biznesët dhe për konsumin e të gjitha familjeve deri në 800 kWh.

Efiçienca e energjisë

investime të realizuara, në proces dhe në vijim

- Rinovuam **142 institucione publike** shëndetësore, arsimore dhe komunale, me mbi 60 mijë përfitues, me vlerë prej **23.7 milionë eurosh**.
- Subvencionuam **3,600 familje** për izolim të shtëpive, me vlerë prej **13.1 milionë eurosh**.
- Në proces: rinovimi i **280 shtëpive** të familjeve të cenueshme, me vlerë prej **3.2 milionë eurosh**.
- Subvencionuam **154 biznese** dhe rreth **42 mijë familje** për pajisje efiçiente elektroshtëpiake e ngrohëse dhe sisteme solare, me vlerë prej **20 milionë eurosh**.
- Izoluam **28 ndërtesa** shumëbanesore sociale, ku përfitojnë 889 familje, me vlerë prej **6.32 milionë eurosh**.
- Në vijim: rinovimi i **400 ndërtesave publike**, me vlerë prej **86 milionë eurosh**.

INOVACIONI DHE TEKNOLOGJIA

100%
e vendbanimeve të mbuluara me internet brezgjerë, ndër 8 vendet e para në Evropë

65%
e territorit të vendit e mbuluar me 5G

320
shërbime elektronike të lansuara në e-Kosova

43
zyra të reja postare, 16 prej tyre në komunat veriore, për herë të parë pas luftës

Hapësirat e inovacionit

Tech Parku në Bërnicë

E përuruam dhe e funksionalizuam, dhe sot aty operojnë **28** startup-e dhe 2 biznese të maturuara, që bashkëpunojnë mes vete dhe u përgjigjen nevojave të tregut ndërkombëtar.



Inaugurimi i Tech Park Prishtina, 12 tetor 2023.

Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve (ITP) në Prizren

Bashkëinvestuam me qeverinë gjermane në platformën më të madhe të inovacionit në vend, me **52** objekte në **39** hektarë, ku tashmë operojnë **61** kompani dhe një universitet.



Mirëpritja e kompanive të para në ITP, 14 prill 2021, me Kryeministrin Kurti, ministren e Industrisë Rozeta Hajdari, ambasadorin gjerman Jörn Rohde dhe kryetarin e Prizrenit Mytaher Haskuka.

- **Platforma e-Kosova:** E shndërruam në kanalin kryesor të shërbimeve publike, me mbi **1.1 milion përdorues** të regjistruar dhe **6.1 milionë transaksione** në vitin 2025, 135% më shumë se në vitin 2022.
- **Interneti në arsim:** Lidhëm në internet brezgjerë dhe ndërlidhëm me rrjetin kërkimor panevropian GÉANT të gjitha universitetet publike e private dhe **250 shkolla** përmes Rrjetit Kosovar për Edukim e Hulumtim (KREN), me investim mbi 2.9 milionë eurosh.
- **Iniciativa OctoberTech:** Mbështetëm ngjarjet më të rëndësishme tradicionale të sektorit të TIK-ut në Kosovë, KOSICT, Doku.Tech, GrowthTank dhe Software Freedom Kosova, për promovimin e mëtejmë të këtij sektori kyç të ekonomisë.

05 Mjedisi, planifikimi hapësinor dhe infrastruktura

INFRASTRUKTURA

82 mil € zvogëlimi i borxhit në shpronësime.

- **Mbrojtja e parasë publike:** Kursyem **150 milionë euro** duke anuluar shpronësimet abuzive në projektin Kijevë–Zahaq.
- **Mirëmbajtja e rrugëve:** Nënshkruam **19 kontrata** të reja, në vlerë prej **51.5 milionë eurosh**.
- **Rrugët e turizmit:** Përfunduam ose jemi drejt përfundimit të rrugëve që ndihmojnë turizmin: Brezovicë–Qendër Skijimi, Brezovicë–Shtërpcë, Gërlicë–Shtërpcë, Prizren–Prevallë, Zhur–Dragash–Brod, Junik–Gjeravicë, Istog–Lugu i Butë.
- **Infrastruktura lokale:** Investuam në **288 projekte** infrastrukturore në bashkëpunim me komunat, nga të cilat 236 (ose 82%) u iniciuan gjatë këtij mandati.
- **Infrastruktura në veri:** Përfunduam **24 projekte**, me afër 100 kilometra rrugë të shtruara dhe 57 kilometra të tjera në proces.
- **Hekurudha:** Përfunduam studimin e fizibilitetit për linjën Prishtinë–Durrës dhe po projektojmë linjat Fushë Kosovë–Klinë–Pejë, **81 km**, dhe Klinë–Prizren, **58 km**.

200 mil €
investime të parapara për rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Hani i Elezit–Leshak

35 mil €
rruga Prizren–Tetovë, ku punimet kanë nisur dhe po ecin sipas planit

800 km
rrugë të ndërtuara gjatë mandatit, kurse qindra kilometra të tjera janë në ndërtim e sipër



Fillimi i punimeve për ndërtimin e rrugës Prizren–Tetovë, 13 gusht 2024.

MJEDISI DHE PLANIFIKIMI HAPËSINOR

- **Prerja ilegale e pyjeve:** E reduktuam për **15%** gjatë vitit 2023.
- **Deponitë ilegale:** I gjysmuam brenda një viti, nga **747** në vitin 2022 në **373** në vitin 2023.
- **Burimet ujore:** Ndamë mbi **10 milionë euro** për rregullimin dhe pastrimin e shtretërve të lumenjve, dhe nisëm projektimin e **pesë digave** për ujë të pijshëm: Dragaqinë, Pollatë, Kuqicë, Desivojcë dhe Firajë.
- **Pyllëzimi:** Mbollëm rreth **1.5 milionë fidanë** gjatë mandatit.
- **Pellgjet lumore:** Aprovuam planin e menaxhimit të pellgut të Drinit të Bardhë dhe hartuam planet për Moravën e Binçës, Ibrin dhe Lepencin.
- **Në planifikim:** Hartimi i Planit Hapësinor të Kosovës, miratimi i Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri" dhe finalizimi i atij për "Bjeshkët e Nemuna".

06 Industria, ndërmarrësia, tregtia dhe inovacioni

60,046 biznese të regjistruara nga 1 mars 2021 deri më 31 mars 2026, ose 10,719 më shumë se në periudhën 2016–2020 (49,327 biznese), një rritje prej 21.7%.

Bizneset e mbështetura

numri i bizneseve të mbështetura gjatë mandatit

711	414	399	170
me potencial eksporti	në panaire ndërkombëtare	prodhuese dhe përpunuese	për digjitalizim

- **Lehtësimi i tarifave:** Tarifat për tregti me produkte të naftës i ulëm nga 500–5,000 euro në **50 euro**, ato për duhan nga 3,000–20,000 euro në **55 euro**, dhe lejet i zgjatëm nga 2 në 6 vjet.
- **Rregullimi i tregut të naftës:** Sot janë të licencuar **98%** e operatorëve ekonomikë, kurse në vitin 2019 mbi gjysma vepronin pa licencë. Gjatë krizës e ruajtëm stabilitetin e tregut duke vendosur çmimin tavan për naftën.
- **Mbështetja e eksportit:** Ndamë **20.5 milionë euro** grante për bizneset me potencial eksporti, dhe **14 milionë euro** për makineri prodhuese e përpunuese te 399 ndërmarrje të vogla e të mesme.
- **Mbrojtja e konsumatorit:** Rritëm trajtimin e ankesave për **475%** gjatë mandatit, mars 2021 deri mars 2026, me 6,546 ankesa të trajtuara, krahasuar me vetëm 1,138 ankesa të trajtuara gjatë periudhës 2016–2020. Vetëm në gjashtë muajt e parë të vitit 2026 u bënë rreth **3,000 inspektime** dhe u shqiptuan rreth **600 mijë euro** gjoba, kurse Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2026–2030 po vendos bazat për një treg më të rregullt e më transparent.
- **Kosova vetë në CEFTA:** Pas 15 vjetësh, me kërkesën tonë u largua përfaqësimi i UNMIK-ut, dhe nga **9 tetori 2024** Kosova përfaqësohet në CEFTA vetëm nga institucionet e veta. Miratuam protokollet shtesë **5, 6** dhe **7**, për thjeshtësimin e procedurave doganore, liberalizimin e shërbimeve dhe zgjidhjen e kontesteve.
- **Tregu i lirë evropian:** Nënshkruam Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me shtetet e EFTA-s: Zvicrën, Norvegjinë, Islandën dhe Lihtenshtajnin. Kosova është vendi i vetëm në rajon që ka negociuar edhe shërbimet.

5,950

biznese me pronarë të huaj të regjistruar nga 1 mars 2021 deri më 31 mars 2026, ose 2,491 më shumë se në periudhën 2016–2020 (3,459 biznese), një rritje më shumë se 72%

22 ligje dhe 54 akte nënligjore

miratuam në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe direktivat e BE-së, reforma të theksuara në Raportet e Progresit për vitet 2023, 2024 dhe 2025

43 mil €

i ndamë Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, që garantoi 44.3 milionë euro nga 89.8 milionë euro kredi për 1,146 biznese mikro, të vogla dhe të mesme, me 2,416 vende të reja pune



Ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes mes Kosovës dhe shteteve të EFTA-s, 22 janar 2025. Marrëveshja hyri në fuqi më 1 tetor 2026.

- **Reformat në IQMT:** Përmes reformave në Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, numrin e inspektorëve të tregut po e rrisim nga **48** në **101**, për një mbrojtje më të fortë të konsumatorit.
- **Reformat në ARBK:** Në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës thjeshtësuam, digjitalizuam dhe përshpejtuam proceset administrative, dhe rritëm transparencën përmes regjistrit të pronarëve përfitues fundorë.
- **Ligji për çmimet tavan:** E miratuam për t'i mbrojtur konsumatorët nga rritjet e pajustifikuara të çmimeve dhe për t'i parandaluar abuzimet në raste krizash.
- **Ligji për inovacion:** E miratuam ligjin për inovacion dhe krijuam Fondin e Inovacionit.
- **Parqet industriale:** Ndërtuam zona të reja industriale në Viti, Suharekë, Vushtrri e Drenas, për **400 biznese**. Projektuam dhe nisëm ndërtimin e parqeve në Podujevë, Drenas II, Lipjan dhe Mitrovicë, zhvilluam konceptin e parqeve industriale të gjelbra (eko) dhe nisëm procesin për krijimin e parqeve në Gjilan, Gjakovë, Zveçan dhe Zubin Potok.

Mbështetja për inovacion

8 mil €	mbështetje për Parkun e Inovacionit dhe Trajnimeve (ITP) në Prizren, 39 hektarë dhe 52 objekte	**1.1 mil €**	skema e granteve për teknologji të informacionit dhe komunikimit (TIK)
1 mil €	skema e granteve për inovacion, për gratë ndërmarrëse	**1 mil €**	Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, 1,000 m² në Universitetin e Prishtinës, në funksion
440 mijë €	Inkubatori i përfunduar në Malishevë dhe Parku Teknologjik i rinovuar në Shtime		

KAPITULLI I DYTË

SOCIALE

Arsimi, shëndetësia, kultura, familjet dhe rinia. Kthimi i shtetit te qytetari.

07	Arsimi	20
08	Modernizimi i sistemit shëndetësor	22
09	Kultura, sporti dhe trashëgimia	24
10	Mirëqenia dhe mbështetja sociale	27
11	Gratë, fuqizimi ekonomik dhe barazia	29
12	Rinia dhe punësimi meritokratik	31

07 Arsimi

Mbi 20 mil € mbështetje direkte për studentët gjatë mandatit.

- **Zgjerimi i çerdheve:** Gjatë këtij mandati, investuam rreth 42.1 milionë euro për 74 çerdhe (**96%** e totalit të investimeve), duke sjellë një rritje prej 50% të numrit të fëmijëve në çerdhe krahasuar me vitin 2020.
- **Arsimi dual:** Nisi në vitin shkollor 2022/2023 me katër profile në katër shkolla profesionale e tri komuna, me 107 nxënës. Sot lidh arsimin profesional me tregun e punës përmes **16** profileve në **32** shkolla në **17** komuna, me mbi **2,500** nxënës, **24** Qendra të Karrierës dhe mbi **250** mësimdhënës e instruktorë të trajnuar.
- **Njohja ndërkombëtare e arsimit dual:** Nga viti 2025 Kosova është anëtare e Aleancës Evropiane për Praktikën Profesionale (EAfA), si vendi i **43-të** anëtar.
- **Bursat:** Ndër vitet 2021–2026, mbi **18,000 studentë** në vend dhe jashtë janë përkrahur me bursa nga 1,000 deri në 10,000 euro, përfshirë studentët në fushat STEM, ata me mesatare të lartë mbi 9.0, doktorantët në universitetet botërore, si dhe bursat e para për post-doktoratë. Ky investim gjithëpërfshirës ka fuqizuar mijëra të rinj, duke përfshirë vajzat në shkenca, ku veçohen bursat për mbi **7,000 vajza** në STEM. Mbështetja për studentët po vazhdon: këtë vit, për herë të parë, po u ofrohet mbështetje edhe studentëve të doktoratës në institucionet vendore të arsimit të lartë.
- **Tekstet shkollore:** Subvencionuam direkt me libra e materiale mësimore **414,000 nxënës**, duke shmangur abuzimet e vjetra.
- **Përfshirja në arsim:** Angazhuam 430 asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta; buxheti për komunat është ndarë për punësimin e gjithsej **500** asistentëve.
- **Edukimi i hershëm:** Miratuam Ligjin për Edukimin e Hershëm, duke e bërë edukimin parafillor të detyrueshëm, dhe pilotuam kurrikulën e re për një vit.

173 mijë

studentë të liruar nga pagesat e semestrave në arsim të lartë

rreth 2,000

bursa për nxënës të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në vlerë 625 mijë euro, dhe 170 bursa për studentë në vlerë 1,000 euro, trefishim i mbështetjes në krahasim me të gjitha qeveritë e kaluara së bashku

Horizon Europe

Anëtarësuam Kosovën në programin më të madh të BE-së për kërkim dhe inovacion (2021–2024 janë financuar 15 projekte në vlerë mbi 1.5 milionë euro)

87 projekte

të vogla shkencore i përkrahëm gjatë mandatit tonë, deri në 10 mijë euro për projekt, në vlerë të përgjithshme prej rreth 681 mijë eurosh

Investimet në arsim

milionë euro



Të katër kategoritë janë investime kapitale të realizuara gjatë mandatit.

Rikthimi në EQAR

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ishte përjashtuar nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) në vitin 2018, për shkak të ndërhyrjeve politike nga qeveria e PDK, AAK, dhe Nisma (PAN): EQAR vlerësoi se Agjencia kishte humbur aftësinë për të vepruar në mënyrë të pavarur dhe autonome. AKA u rikthye në regjistrin e EQAR në vitin **2025**, dhe Kosova është vendi i parë në Ballkanin Perëndimor me të drejta të plota anëtarësie. Anëtarësimi në EQAR u mundëson universiteteve dhe studentëve tanë qasje të plotë në programet e BE-së dhe përfitim nga mobiliteti, bursat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.



Çerdhet

Mjedise të Institucionit Parashkollor "Fluturat".

Investim prej mbi 742 mijë eurosh nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Me një hapësirë prej 1,800 m², akomodon deri në 160 parashkollorë. U përurua në tetor të vitit 2024.



Arsimi dual

Ceremonia e diplomimit të gjeneratës së parë të profilit Floktari, në Qendrën e Kompetencës "Shtjefën Gjeçovi", maj 2025.

Në vitin shkollor 2025/2026, arsimit dual iu shtuan edhe dy profile të reja: Zhvillues i Aplikacioneve Softuerike dhe Teknik i Informatikës së Biznesit.



Asistentët për fëmijët me nevoja të veçanta

Diplomimi i gjeneratës së pestë të asistentëve, mars 2024.

Kualifikimi i asistentëve është njëvjeçar, me program ndërkombëtar dhe intensiv.



Bursat

Takim me përfitues të bursave studentore, dhjetor 2024.

08 Modernizimi i sistemit shëndetësor

396.1 mil € buxheti i shëndetësisë për vitin 2026, ose **10%** i buxhetit vjetor të shtetit.



Nga 233 milionë euro sa ishte në vitin 2019 dhe 200 milionë euro në vitin 2021, ky buxhet arriti në 365.8 milionë euro në vitin 2025 (pa llogaritur kreditë dhe donacionet) dhe në 396.1 milionë euro në vitin 2026.

- **Pajisjet mjekësore:** Nënshkruam marrëveshje financimi prej **41 milionë eurosh** me Bankën Evropiane të Investimeve (EIB) dhe Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës (CEB), për pajisje mjekësore të teknologjisë më të fundit në institucionet publike shëndetësore.
- **Rregullimi i çmimeve:** Miratuam Ligjin për çmimet e unifikuara, duke ulur kostot në mbi **2,900 produkte** medicinale.
- **Sigurimet shëndetësore:** Miratuam Ligjin për Sigurimet Shëndetësore, me **12.2 milionë USD** të parapara për investime në Sistemin Informativ Shëndetësor (SISh).
- **Lista e Barnave Esenciale**: Shumëfishuam buxhetin nga 24 milionë euro sa ishte para mandatit tonë, në **63 milionë euro** në vitin 2025.
- **Sëmundjet e rralla:** Për herë të parë ndamë fonde të rregullta shtetërore për **63 sëmundje** të rralla.
- **Mbrojtja e grave:** Në vitin 2026, mbi **53.4%** e rasteve të kancerit të gjirit diagnostikohen në stadet e hershme, ndërsa mamografia, protezat dhe rikonstruktimi i gjirit ofrohen falas nga shteti.
- **Më shumë profesionistë në shëndetësi:** Gjatë 3 viteve të fundit të mandatit tonë i kemi shtuar **370** infermierë, **300** mjekë në kujdesin parësor shëndetësor, dhe **250** specialistë në kujdesin sekondar e terciar.
- **Vlerësimi i specialistëve:** Për një kujdestari 24-orëshe gjatë fundjavës, mjekët specialistë tani paguhen **285 euro**.
- **Inspektimi shëndetësor:** Trefishuam numrin e inspektorëve shëndetësorë dhe farmaceutikë.

Pagat në shëndetësi

euro në muaj



1,257

profesionistë shëndetësorë të rinj në institucionet publike nga 2021 deri në 2025.

3 rezonanca të reja magnetike

për Spitalin e Pejës, Klinikën e Pediatrisë në QKUK dhe Spitalin e Prizrenit

mbi 70

barna të reja në listën e barnave esenciale

Kujdes i zgjeruar dhe shërbime të reja

çka ofrohet sot në sektorin publik shëndetësor

Kujdesi paliativ dhe vizitat në shtëpi	Gjatë vitit 2025 u realizuan **144,231** vizita në kujdesin paliativ dhe **35,170** vizita në kuadër të programit të vizitave në shtëpi për gra shtatzëna dhe fëmijë 0–3 vjeç.
Shëndeti riprodhues, kujdesi për nënën dhe fëmijën	Fertilizimi i asistuar (IVF), mjekësia fetale, amniocenteza, skriningu neonatal për zbulimin e hershëm të sëmundjeve dhe përmirësimin e mbijetesës së foshnjave, si dhe plazmafereza pediatrike.
Parandalimi dhe imunizimi	Përfshirja e **tri vaksinave të reja** në kalendarin e rregullt të imunizimit: kundër HPV-së, pneumokokut dhe rotavirusit.
Parandalimi dhe diagnostikimi i kancerit	Fuqizimi i skriningut të kancerit të gjirit përmes mamografëve, diagnostikimi i avancuar me PET-Scan dhe analizat e specializuara përmes citometrisë së rrjedhës (Flow Cytometry).
Diagnostikimi dhe trajtimi i avancuar	Neuroendoskopia, ultrazëri endoskopik, endoskopia me kapsulë, toksikologjia klinike dhe plazmafereza për të rritur.
Shëndeti i syve	Diagnostikimi dhe trajtimi i retinopatisë dhe sëmundjeve të tjera oftalmologjike.
Stomatologjia	Tani në sektorin publik: sedacioni inhalator është **falas**; implanti dentar **170 euro** (privat kushton mbi 400 euro); proteza fikse për një nofullë **100 euro** (privat rreth 600 euro).

INVESTIMET NË KLINIKA DHE PAJISJE

9 klinika dhe blloqe operative i transformuam e rinovuam: Onkologjia, Gjinekologjia, Urologjia, Kardiokirurgjia e Oftalmologjia, Klinika Emergjente, bllokët operative të Neurokirurgjisë–Kirurgjisë Vaskulare dhe të Kirurgjisë Torakale, si dhe Psikiatria e Fëmijëve e Adoleshentëve.



Klinika Emergjente, QKUK

Rinovim me afër 800 mijë euro, investim i përbashkët i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. Në foto: dhomë e re ekzaminimi me monitorim dhe ultrazë.



Spitali Rajonal i Prizrenit

Laboratori i ri i kateterizimit, 3 milionë euro, me mbi 2 milionë donacion nga Luksemburgu. Në foto: angiografi i ri.





Klinika e Onkologjisë, QKUK

Në foto, majtas: salla e terapisë ditore, ku pacientët marrin terapinë pa qëndruar të shtruar. Djathtas: akseleratori i ri linear, në bunkerin e tij të ri. Investimi i përbashkët është 2.7 milion euro, nga të cilat 1.6 milion vetëm akseleratori.


09 Kultura, sporti dhe trashëgimia

27.1 mil € buxheti i kulturës për vitin 2026

Trashëgimia kulturore	Turizmi	Arkivat
16.9 mil €	**160 mijë €**	**2.5 mil €**

KULTURA

Buxheti i institucioneve të kulturës



9 mil €
mbështetja vjetore për skenën e pavarur dhe artin, nga 1.5 milion euro sa e gjetëm

mbi 300
projekte infrastrukturore në fushën e kulturës anembanë Kosovës në këtë mandat

1 mil €
buxheti për librin dhe autorin, nga 150 mijë euro sa ishte

118 instrumente
muzikore të shpërndara në 29 institucione kulturore dhe arsimore

- **Reforma ligjore:** Zhvilluam reformën më të thellë kulturore në vend, miratuam ligjet për artin dhe kulturën, kinematografinë, të drejtën e autorit e arkivat shtetërore. Vetëm gjatë vitit 2026 miratuam rregulloret për Këshillin Kombëtar të Arteve, Këshillin e Skenës së Pavarur, zgjedhjen e drejtorëve të institucioneve të kulturës, arkivat private dhe zyrtarët arkivorë, statutin e Teatrit të Operas, Baletit dhe Ansamblit Kombëtar, dhe përfunduam draftin e Ligjit për Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore.
- **Bashkëpunimi ndërkombëtar:** Arkivat tona nënshkruan marrëveshje me Arkivin Kombëtar të Hungarisë, Biblioteka Kombëtare "Pjetër Bogdani" me atë të Hungarisë dhe me "Marcianën" e Venecias, dhe u anëtarësua në rrjetin evropian "TRADUKI".
- **Institucione dhe projekte të reja:** Themeluam Operën e Kosovës, Muzeun e Artit Bashkëkohor dhe Agjencinë e Rinisë, dhe nisëm projektin për Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz dhe atë në Reçak.
- **Fëmijët dhe të rinjtë:** Krijuam programet "Sporti në Shkolla", "Arti në Shkolla" dhe "Drejt Malit", ku vetëm në fazën testuese përfituan afër **20 mijë nxënës**.

TRASHËGIMIA

- **Trashëgimia kulturore:** Përfunduam **120 ndërhyrje** restauruese dhe 65 janë në zbatim; për vetëm 4 vite kemi restauruar më shumë sesa në 2 dekadat pararendëse bashkë. Vetëm në vitin 2026 përfunduam **35 projekte** konservimi e restaurimi në mbarë vendin, mes tyre renovimin e ndërtesës së Galerisë Kombëtare të Kosovës dhe restaurimin e kompleksit të Kishës Katolike "Engjëlli i Rojës" në Ferizaj.
- **Dëmet e luftës:** Dokumentuam shkatërrimin e trashëgimisë sonë gjatë luftës 1998–1999, me rreth **1,800 monumente** të shkatërruara dhe mbi **3,700 artefakte** të grabitura, dhe raportin ia dorëzuam Institutit për Krimet e Kryera gjatë Luftës, në betejën për drejtësi e dëmshpërblim nga Serbia.

TRASHËGIMIA (VAZHDIM)

Trashëgimia që po nxjerrim në dritë

gati 4 herë më shumë buxhet se në vitin 2021

1 · IUSTINIANA SECUNDA (ULPIANA)

Gërmimet po nxjerrin në dritë një qytet të tërë të fortifikuar, me rrjet rrugor të planifikuar, të ngritur nga perandori Justinian I pranë mureve të Ulpianës pas tërmetit të vitit 518 pas Kr.

ZBULIMET KRYESORE

Katedralja

Bazilika episkopale e qytetit, rreth 77 × 24 m, e identifikuar me matje gjeofizike dhe e gërmuar që nga viti 2022

Mbishkrimet

2023 dedikim i Justinianit dhe Teodorës, me shprehjen *urbs Dardaniae*

2025 nëntë rreshta që e emërtojnë qytetin *Iustiniana Secunda*

Pagëzimorja

Strukturë në jug të katedrales, e interpretuar paraprakisht si pagëzimore, që po dokumentohet gjatë gërmimeve të vitit 2026

2 · SHESHI I LIDHJES, PRIZREN

Gjatë punimeve për rregullimin e sheshit, në vitin 2014, dolën shtresëzime kulturore të dy epokave, asaj klasike romake dhe asaj osmane. Strukturat romake mendohet se janë të një shtëpie (vile) të shekujve III–IV, kurse ato osmane janë muret e pazarit të bylmetit, që ka ekzistuar deri në mesin e shekullit XX.



Galeria Kombëtare e Kosovës pas renovimit.



Mbishkrimi i perandorit Justinian në qytetin dardan të Ulpianës, zbuluar në vitin 2025.

SPORTI

mbi 37 mil € mbështetja vjetore për sportin në vitin 2025.

Nga sa ishte, në sa është sot

mbështetje direkte nga Qeveria, milionë euro në vit



Mbështetja e drejtpërdrejtë në vitin 2026

FEDERATAT DHE KOMITETET

6.5 mil €

mbështetje për 39 federata sportive

mbi 1 mil €

mbështetje për Komitetin Olimpik të Kosovës

200 mijë €

mbështetje për Komitetin Paralimpik të Kosovës

SPORTI (VAZHDIM)

Kosova, shtet i xhudos

550 mijë €

financim për programin "Kosova Shtet i Xhudos"

SPORTI YNË ME MEDALJE OLIMPIKE

mbi 5.7 mil €

investim për Qendrën Nacionale të Xhudos në Pejë

- **Infrastruktura sportive:** Po e zbatojmë planin pesëvjeçar të infrastrukturës së futbollit, në 18 komuna, mbi 20 stadiume, me **200 milionë euro** investime, si dhe po investojmë në palestra, pishina e terrene sportive në mbarë Kosovën.
- **Lojërat Mesdhetare 2030:** Kosova fitoi të drejtën e organizimit, ndamë **250 milionë euro** investime për këtë ngjarje të parë multisportive të këtij niveli, dhe miratuam Ligjin për Lojërat Mesdhetare "Prishtina 2030".
- **Institucionet e sportit:** Themeluam Agjencinë e Sportit dhe Agjencinë Antidoping.



Qendra Nacionale e Xhudos në Pejë.



Ekipi olimpik i Kosovës, Team Kosova, me 163 sportistë, trajnerë e zyrtarë, para Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, para Lojërave Mesdhetare "Taranto 2026".

10 Mirëqenia dhe mbështetja sociale

400 mijë
fëmijë deri në moshën 16-vjeçare marrin shtesa mujore nga shteti

30 € në muaj
për secilin fëmijë, në familjet me deri në dy fëmijë

45 € në muaj
për secilin fëmijë, në familjet me tre a më shumë fëmijë

20%
rritja e shumës së ndihmës sociale në vitin 2025 (shuma për familje fillon me 84 euro për familjen njëanëtarëshe dhe maksimum është deri në 350 euro për familjen shumanëtarëshe)

444
numri i përfituesve të asistencës sociale të ndërmjetësuar në tregun e punës dhe në trajnime

2 mil €
mbështetje për 19 kuzhina popullore dhe afër 37 mijë pako ushqimore për familjet në nevojë

Pensioni minimal, nga 90 në 150 euro

në fund të secilës rritje, euro në muaj



- **Fuqizimi i inspektimit:** Rekrutuam **36 inspektorë** të rinj, duke e rritur numrin e inspektorëve të punës në **90**, dhe filluam zbatimin e inspektimit elektronik për të rritur cilësinë, transparencën dhe efikasitetin e inspektimeve.
- **Dinjiteti i pensionistëve:** Pensionin bazik e rritëm **tri herë** gjatë mandatit, nga 90 në 150 euro, dhe **7 herë** ndamë shtesa të njëhershme prej 100 eurosh për çdo pensionist.
- **Mbështetja për përballimin e kostos së jetesës:** Përmes pakove mbështetëse ndamë pagesa të njëhershme prej **100 eurosh** edhe për studentët, fëmijët dhe punonjësit e sektorit privat.
- **Sigurimet sociale ndërkombëtare:** Iniciuam nënshkrimin e marrëveshjeve me Austrinë dhe Turqinë, për njohjen e periudhave të sigurimit dhe lehtësimin e realizimit të të drejtave pensionale për qytetarët që kanë punuar në këto vende.
- **Paga e 13-të:** Në mars të vitit 2026 shpërndamë për herë të parë pagën e 13-të për rreth **85 mijë** punonjës të sektorit publik, për të mbështetur mirëqenien e familjeve dhe për të rritur fuqinë blerëse në ekonomi.

Mbështetja për kategoritë e luftës

Rritëm pensionet për familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së, invalidët e luftës dhe familjet e tyre pas vdekjes së invalidit, si dhe për familjet e viktimave civile.

Pensioni i veteranëve të UÇK-së

170 € → **204 €** në muaj

Pensioni i viktimave të dhunës seksuale të luftës

230 € → **276 €** në muaj

- **Trajtimi i familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurve:** Hoqëm trajtimin diskriminues për familjet me dy a më shumë dëshmorë ose të zhdukur të UÇK-së, duke i rritur pensionet sipas numrit të tyre, deri në **1,613.27 euro** në muaj për familjet me më shumë se katër dëshmorë ose të zhdukur.

- **Mbrojtja e lehonave:** Mbështetëm gati **80 mijë** nëna lehona përmes shtesave mujore, të cilat i rritëm nga 170 euro në fillim të skemës, në 325 euro dhe më pas në **500 euro** në muaj.

- **Masa për familjet:** Punësuam mbi **4 mijë persona** (prej tyre 55% gra) të cilët nuk kanë pasur asnjë anëtar të familjes të punësuar, përmes programit "Qeveria për familjet".

- **Mbështetja ushqimore:** Vetëm në vitin 2026 lidhëm marrëveshje me **27 organizata** për shpërndarjen e deri në **10 mijë pako** ushqimore për familjet në nevojë, me së paku 70% produkte vendore.

- **Mbështetja në krizën energjetike:** Përmes Programit për Mbrojtjen e Konsumatorëve të Cenueshëm të Energjisë Elektrike, mbi **90 mijë familje** u kualifikuan për subvencionim të faturës së energjisë për 6 muaj me radhë. Gjatë viteve 2023–2026, për një periudhë prej 6 muajsh gjatë një viti, subvencionimi përfshiu gjithsej nga **70 deri në 100 mijë familje**.

- **Shoqëri gjithëpërfshirëse:** Ofruam trajnim dhe punësim për **239 persona** me aftësi të kufizuara (120 gra e vajza) dhe licencuam **6** Ndërmarrje Sociale të para për punësimin e kategorive të cenueshme.

- **Reforma e asistencës:** Hoqëm kriterin përjashtues që largonte familjet në nevojë nga skema sociale në rast punësimi.

11 Gratë, fuqizimi ekonomik dhe barazia

12 mijë gra të punësuara me mbështetje direkte.

- **Përfshirja financiare:** Rreth **100 mijë gra** hapën xhirollogari bankare personale për herë të parë, falë masave afirmative.
- **Borde dhe menaxhim:** Gjysma e anëtarëve të bordeve të emëruar nga Qeveria sot janë gra, nga vetëm **10%** sa ishin më përpara.
- **Bursat STEM:** Nga bursat në fushat STEM, **7,042** shkuan për vajza, duke çuar pjesëmarrjen e tyre në gjysmën e totalit.
- **Qasja në pronë:** Siguruam regjistrimin e përbashkët të pronës pa asnjë pagesë, duke arritur në **31,124** prona të regjistruara në fund të vitit 2025, nga vetëm 105 sa ishin në vitin 2016, gati duke e treqindfishuar këtë shifër për më pak se një dekadë.
- **Vaksina kundër HPV-së:** Siguruam vaksinat kundër virusit HPV, që parandalon kancerin e qafës së mitrës, për vajzat deri në moshën 15-vjeçare.
- **Vajzat në drejtime teknike:** Për vitin shkollor 2025/26, nga **100 bursa** për nxënësit e klasës së dhjetë në arsimin profesional, **40** i ndamë për vajzat që zgjedhin drejtime teknike. Vlera e secilës bursë është **500 euro** për një vit shkollor.
- **Gratë në sport:** Dyfishuam mbështetjen për sportistet dhe trajneret femra.
- **Masa për viktimat:** Qeveria subvencionon **70%** të pagës për gratë viktima të dhunës në familje.

42%
pjesëmarrja e grave në administratën publike

476
pozita drejtuese në institucione publike të mbajtura nga gra

82 gra
oficere korrektuese u punësuan në Shërbimin Korrektues nga marsi 2021 deri në mars 2026, kundrejt vetëm 16 në periudhën 2018–2021

7.3 mil €
mbështetje financiare për strehimoret dhe OJQ-të e licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare për periudhën 2021–2025

GRATË (VAZHDIM)

Gratë në uniformë

numri i grave në shërbim

Policia e Kosovës **1,498**

1,223 të uniformuara dhe 275 staf civil. Nga to, në grada udhëheqëse: 4 kolonele, 3 nënkolonele, 8 majore, 15 kapitene, 24 togere dhe 95 rreshtere.

Forca e Sigurisë **411**

Nga to, në grada udhëheqëse: 1 gjeneralmajore, 1 kolonele, 3 nënkolonele dhe 3 majore. 15 kadete janë në proces.

Njësi speciale, kufi **57**

14 në njësitë speciale, 43 zyrtare patrulluese në Departamentin e Kufirit.

Rekrutimet e reja në administratë

pjesa e grave mes të punësuarve të rinj, gjatë mandatit

Viti 2023 **32%**

Vitet 2024 dhe 2025 **mbi 60%**

Në vitin 2024, 63% e atyre që janë punësuar në administratë publike ishin gra e vajza, 31% më shumë se në 2023. 80% e tyre nuk kishin punuar më parë në administratë. Edhe në 2025, 60% e të rekrutuarve ishin gra dhe vajza.



Ceremonia e betimit të kadetëve të Policisë së Kosovës.

12 Rinia dhe punësimi meritokratik

23 mijë të rinj të moshës 18–29 vjeç (51% vajza) u punësuan përmes platformës Superpuna në 10,500 biznese vendore.

5,000 të rinj
u trajnuan falas në programim dhe digjitalizim, ku rreth 84% u punësuan

mbi 35%
e nëpunësve civilë në vitin 2025 ishin nën moshën 40 vjeç, nga 32% një vit më parë, kurse grupmosha 18–30 vjeç u rrit nga 990 në 1,137

12,228 të rinj
morën Kartën Evropiane Rinore falas, me qasje në mbi 60 mijë përfitime në Evropë; Kosova u anëtarësua me të drejta të plota në EYCA dhe Karta u zgjerua edhe në nivel komunal, me Municipality Youth Card

Të rinj 15–24 vjeç në punë — **më shumë se dyfishim**
persona në marrëdhënie pune



e trashëguar · gjatë mandatit tonë

- **Barazia në punësim:** Kemi siguruar barazi në tregun e punës, ku gjysma e punësimeve të reja për të rinjtë u takon vajzave.
- **Praktikë profesionale dhe gjithëpërfshirje:** Përmes programit Kosovo Generation Unlimited, në bashkëpunim me UNICEF-in në Kosovë, Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) dhe rrjetin CSR Kosova, kemi ofruar mundësi praktike për mbi **3 mijë** të rinj (59% vajza, 14% nga komuniteti serb dhe 4% nga komunitetet e tjera joshumicë).
- **Shërbimet e punësimit dhe aftësimi profesional:** Vetëm gjatë vitit 2026, përmes APRK-së ndërmjetësuam në punësim **2,285 persona** në mënyrë të rregullt dhe **1,698** përmes masave aktive të tregut të punës, dhe ofruam aftësim profesional për **1,877 kandidatë**, prej tyre 817 gra.
- **Trajnimet në teknologji:** Ndamë **574 mijë euro** kuponë trajnimi për maturantët në fushën e teknologjisë.
- **Mbështetje masive për studentët:** Kemi bërë arsimin e lartë publik falas dhe kemi mbështetur mbi **18,000 studentë** me bursa nga **1,000 euro** deri në **10,000 euro** (nga viti 2021 në 2026), ku vlera e bursës është rritur nga 700 euro në 1,000 euro.

Rinia në qendër të politikave

VULLNETARIZMI
Riaktivizuam **Kosovo Volunteers**, platformën shtetërore për certifikimin dhe promovimin e vullnetarizmit, e cila po zgjerohet edhe për vullnetarë vendorë e ndërkombëtarë.

MUAJI I RINISË
Shtatori është shpallur Muaj i Rinisë, me aktivitete rinore në mbarë Kosovën për një muaj rresht.

LIGJI DHE STRATEGJIA
Ka nisur zbatimi i Ligjit për Rininë dhe i **Strategjisë Shtetërore për Rininë 2024–2032**, si dhe procesi i themelimit të Këshillit Konsultativ për Komunitete.





Lansimi i platformës "Superpuna", shkurt 2023.

KAPITULLI I TRETË

SIGURI

Ushtria, policia, drejtësia dhe rendi kushtetues. Ligjshmëri dhe siguri në çdo cep të Republikës së Kosovës.

13	Mbrojtja dhe ushtria	33
14	Sundimi i ligjit, luftimi i korrupsionit dhe siguria kombëtare	35
15	Konsolidimi i sistemit të drejtësisë	37
16	Shtrirja e ligjshmërisë në veri	39

13 Mbrojtja dhe ushtria

Trefishuam buxhetin e ushtrisë; në 2025 ishte 208 milionë euro apo mbi 2% të BPV sipas standardeve të NATO-s.

Nga sa ishte, në sa është

INVESTIMET NË ARMATIM, MILIONË EURO



Dyfishuam
numrin e ushtarëve të rekrutuar (+2,705); FSK-në e gjetëm me 2,200 ushtarë

3,325
ushtarakë u trajnuan në akademitë aleate; katërfishim i trajnimeve jashtë vendit

2025
viti kur Kosova ishte vend nikoqir i stërvitjes më të madhe ushtarake ndërkombëtare Defender Europe

Çka bleu Qeveria?

RAKETA DHE ARTILERI

Sistemi raketor kundërtank Javelin
Artileria mobile HAWKEYE 105 mm
Sistemet raketore kundërtank Panzerfaust 3, OMTAS dhe HAR-66
Sistemet e mortajave 60 mm, 81 mm dhe 120 mm
Sistemi automatik i mortajës ASELSAN ALKAR 120 mm, me kullë elektro-mekanike të integruar në automjetin ushtarak BMC Vuran

FLUTURAKE PA PILOT

Dronë luftarakë Bayraktar
Dronë amerikanë PUMA
Mijëra Skydagger 7" dhe 15"

LOGJISTIKË DHE MUNICION

15 kamionë multifunksionalë Rheinmetall (10 të blerë, 5 donacion)
Armatim e municion nga 7 shtete aleate

NË PËRGATITJE **blerja e helikopterëve Black Hawk**

- **Sistemet e armatimit:** Për 12 vjet, FSK-ja kishte vetëm një lloj pushke, të prodhuar nga Heckler & Koch, dhe një lloj pistolete, Glock. Gjatë qeverisjes sonë, arsenali është zgjeruar në **mbi 40 lloje** sistemesh armatimi, përfshirë pushkë individuale, mitralozë të rëndë dhe të lehtë ekiporë, si dhe pushkë moderne snajperësh.
- **Industria e mbrojtjes:** Nënshkruam kontratën për fabrikën e parë të municioneve, e cila do të jetë ndërmarrje publike dhe do të prodhojë me markë **100% vendore**. Po bashkëpunojmë me sektorin privat dhe me partnerët ndërkombëtarë për prodhimin e mjeteve ajrore dhe tokësore pa pilot (UAV dhe UGV), dronëve FPV, si dhe pajisjeve dhe municioneve të tjera ushtarake.
- **Aleancat e mbrojtjes:** Nënshkruam marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes me shtete anëtare të NATO-s dhe me vende partnere të Aleancës, përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Turqinë, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Italinë, Shqipërinë, Malin e Zi, Kroacinë dhe Maqedoninë e Veriut, ndër të tjera.



Pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës gjatë stërvitjes ndërkombëtare Defender Europe, prill 2025. Kosova ishte vendi nikoqir i kësaj stërvitjeje.



Patrullimi tokësor i Policisë së Kosovës.



Patrullimi ujor i Policisë së Kosovës.

14 Sundimi i ligjit, luftimi i korrupsionit dhe siguria kombëtare

67 mil € mallra dhe asete të sekuestruara dhe konfiskuara nga operacionet e Doganës së Kosovës (nga fillimi i mandatit deri në fund të vitit 2025).

37
rrugë ilegale të mbyllura, prej tyre 29 në veri të vendit

mbi 6.7 tonë
substanca narkotike të konfiskuara

23
laboratorë të drogës të shkatërruar (13 në veri)

Para mandatit dhe gjatë mandatit tonë

BUXHETI I POLICISË, MILIONË EURO

81% më shumë se në vitin 2021



Shifra e vitit 2026 është buxheti fillestar i miratuar; në fund të vitit fiskal ai do të rritet si rezultat i transfereve nga suficitet e organizatave buxhetore.

e trashëguar · gjatë mandatit tonë

ARMATIMI DHE BLINDAT E POLICISË SË KOSOVËS	DERI MË 2021	SOT	NDIKIMI
Armë të gjata	750 copë	→ 7,800 copë	Rritje mbi 10-fish
Mitralozë 12.7 mm	vetëm 2 copë	→ mbi 70 copë	Rritje 35-fish
Automjete të blinduara	30 blinda	→ mbi 70 blinda	Më shumë se dyfishim

167 GRUPE DHE BANDA KRIMINALE TË SHKATËRRUARA — secila pikë është një grup



Inspektimet e tregut, nga viti në vit

92% më shumë brenda dy viteve

3,079 (2023) → **4,742** (2024) → **5,924** (2025)

inspektime në terren të Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT). Shifra e vitit 2025 është **më e larta e regjistruar ndonjëherë** në historinë e këtij inspektorati.

- **Antikorrupsioni shtetëror:** U arrestuan mbi **350 zyrtarë** publikë dhe nisëm kallëzime penale për korrupsion ndaj mbi **1,600 personave**.
- **Hetimi historik për sulmin terrorist në Banjskë:** Nga hetimet e sulmit terrorist dhe paramilitar të 24 shtatorit 2023, kemi sekuestruar alarme, kamera të strukturave ilegale, si dhe armatim e asete në veri në vlerë rreth **15 milionë euro**. Ky konsiderohet si hetimi më i madh në historinë e Policisë, me mbi 300,000 prova, vetura, prona dhe armë të konfiskuara.
- **Kriptovalutat ilegale:** Shkatërruam **10 laboratorë** të prodhimit të kriptovalutave në veri, me pajisje të konfiskuara në vlerë 488.9 mijë euro.

SUNDIMI I LIGJIT (VAZHDIM)





Pjesë e armatimit të konfiskuar pas sulmit terrorist në Banjskë, 24 shtator 2023.

15 Konsolidimi i sistemit të drejtësisë

mbi 215 mil € të kursyera për buxhetin e shtetit gjatë mandatit, nga mbrojtja e interesave të Republikës së Kosovës në gjykata e arbitrazh.

145 mil € nga 3 fitore të Republikës së Kosovës në arbitrazhin ndërkombëtar

mbi 70 mil € nga përfaqësimi i Avokaturës Shtetërore në kontestet gjyqësore brenda vendit

Çka ndryshuam në sistemin e drejtësisë?

- **Vetingu:** Amendamentet kushtetuese për vetingun e niveleve të larta të drejtësisë janë finale dhe të gatshme për votim në Kuvend.
- **Sistemi prokurorial dhe KPK:** Miratuam pakon e re ligjore të sistemit prokurorial dhe **reformuam thellësisht** Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili tashmë funksionon me përbërje të re e të balancuar (jo korporatiste), të bazuar në kritere profesionale, të integritetit dhe të llogaridhënies.
- **Drejtësia administrative:** Reformuam drejtësinë administrative, me gjykatë të specializuar funksionale dhe legjislacion të ri.
- **Llogaridhënia:** Miratuam ndryshimet penale që mundësojnë ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike për zyrtarët abuzues, si dhe miratuam ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale të cilat mundësojnë largimin e zyrtarëve publikë me aktakuzë.
- **Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar:** Avancuam dhe forcuam sovranitetin e Republikës me marrëveshje të reja për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, me **mbi 35 akte** e nisma për marrëveshje të tilla, si dhe me **25,516 kërkesa** dhe përgjigje me shtete të ndryshme në kuadër të këtij bashkëpunimi.

- **Juristët e certifikuar dhe noterët e rinj:** Gjatë mandatit tonë certifikuam **897 kandidatë** në 6 procese testuese, si dhe emëruam mbi **100 noterë** të rinj, duke e trefishuar numrin e tyre.
- **Krimet e luftës:** Themeluam Institutin për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë (IKKL), miratuam Strategjinë për Drejtësinë Tranzicionale dhe mundësuam gjykimin në mungesë për kriminelët e luftës përmes ndryshimeve procedurale penale.
- **Viktimat e krimit:** Miratuam Ligjin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, paguam **afër 1 milion euro** kompensim (nga muaji mars 2021 e deri më prill 2026) dhe u siguruam ndihmë juridike falas.
- **Lirimet nga tarifat:** Liruam në tërësi nga tarifat noteriale fëmijët pa kujdes prindëror, personat me nevoja të veçanta dhe përfituesit e Ligjit për Ndihmë Juridike Falas, si dhe liruam 100% nga tarifat përmbarimore skemat sociale, pakot emergjente dhe pensionet deri në vlerën e pagës minimale.

Drejtësia më afër qytetarit

2
gjykata të reja në funksion
Gjykata Komerciale dhe Gjykata Administrative

7
zyra alternative noteriale
Malishevë, Rahovec, Obiliq, Kamenicë, Istog, Kaçanik, Klinë

9
zyra mobile me ndihmë juridike falas
Podujevë, Klinë, Vushtrri, Lipjan, Shtime, Rahovec, Kaçanik, Viti, Hani i Elezit



Funksionalizimi i Gjykatës Komerciale dhe Gjykatës Administrative, Pallati i Drejtësisë, Prishtinë



Lehtësimi i qasjes në drejtësi përmes Zyrës Mobile për Ndihmë Juridike Falas

PARANDALIMI DHE ADRESIMI I DHUNËS NË FAMILJE DHE ASAJ ME BAZË GJINORE

5	projekt-akte nënligjore të hartuara e të finalizuara, që dalin nga Ligji nr. 08/L-185 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna në baza gjinore
9	institucione regjistrojnë rastet në bazën nacionale të të dhënave, pas krijimit të moduleve të reja
1,009	qytetarë përfituan ndihmë juridike falas, nga 1 marsi 2021 deri më 31 dhjetor 2025 **687** në çështje civile **322** në çështje penale

Pakoja me pesë ligje për reformën në drejtësi

DEKLARATA E PËRBASHKËT E ZOTIMEVE

Grupi punues i udhëhequr nga Ministria e Drejtësisë ka pasur për detyrë harmonizimin e kësaj pakoje legjislative, për të adresuar llogaridhënien dhe integritetin në sistem. Më 5 tetor 2026, Kuvendi i Kosovës i miratoi në lexim të parë pesë projektligjet.

1. Rekrutimi, vlerësimi i performancës dhe kontrolli i integritetit të gjyqtarëve e prokurorëve
2. Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe prokurorëve
3. Ndryshimet në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës
4. Ndryshimet në Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës
5. Akademia e Drejtësisë



Grupi punues i Deklaratës së Përbashkët të Zotimeve për Reformën në Drejtësi

16 Shtrirja e ligjshmërisë në veri

10,365 dokumente ilegale të Serbisë u zëvendësuan me ato të Republikës së Kosovës: 4,040 targa dhe 6,325 patentshoferë.

844
biznese të reja të regjistruara në komunat veriore, 2021–2025

71
prona të uzurpuara u liruan, ku u kthyen 69 shqiptarë dhe 2 serbë

152
shtëpi të ndërtuara dhe 4 të rinovuara, në vlerë 7.8 milionë euro

Fundi i ilegalitetit

ÇKA U MBYLL DHE U NDALUA?

- ✕ Mbyllëm të gjitha **28 komunat paralele** të Serbisë dhe 5 qarqet administrative.
- ✕ Mbyllëm **62 institucione** ilegale të Serbisë që vepronin në Kosovë.
- ✕ Mbyllëm **6 filiale** të Bankës Postare të Kursimeve të Serbisë.
- ✕ Bastisëm e mbyllëm "Bankën Popullore të Serbisë" dhe "Drejtorinë e Thesarit" në Leposaviq.
- ✕ Ndaluam hyrjen dhe përdorimin e dinarit, si dhe kamionët që e transportonin.
- ✕ Shpallëm "Brigadën e Veriut" dhe "Mbrojtjen Civile" organizata terroriste më 29 qershor 2023.
- ✕ Mbyllëm **29 rrugë ilegale** në veri të vendit.
- ✕ Eliminuam të gjitha targat, letërnjoftimet dhe patentshoferët ilegalë të Serbisë në veri të vendit.

ZGJEDHJET DHE REFERENDUMET E SERBISË NË TERRITORIN TONË

31
palë zgjedhje dhe 3 referendume të Serbisë që nga çlirimi i Kosovës në vitin 1999

8
palë zgjedhje dhe 1 referendum prej tyre pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës

0
nën qeverisjen tonë; asnjë palë zgjedhje (nga tre sosh) dhe asnjë referendum i Serbisë (nga një sosh) s'është lejuar në Republikën e Kosovës

Shteti në shërbim

ÇKA U HAP?

- **Zyrat kyçe:** zyrat kadastrale, të ARBK-së, pensionale, të punësimit, zyra rajonale e ATK-së, pikat e Postës së Kosovës dhe Telekomit të Kosovës, zyrat e KRU Mitrovicës, si dhe zyra e Fondit të Kosovës për Efiçiencë të Energjisë.
- **Inspektorati i Punës:** zyra në veri të Mitrovicës dhe në Zveçan (në Zubin Potok dhe Leposaviq të gatshme).
- **Shkollat e reja:** nisi ndërtimi i 2 shkollave dhe i një çerdheje në veri të Mitrovicës.
- **Qendra për patentshoferë:** e para rajonale, shërben për jugun dhe veriun e Mitrovicës, Zubin Potokun, Zveçanin, Leposaviqin, Vushtrrinë dhe Skënderajn.
- **Kërkimi dhe shpëtimi:** qendra e trajnimit e AME-së në Zubin Potok, buzë Liqenit të Ujmanit.

- **Penda e Ujmanit:** Policia e mori nën kontroll pendën që ishte nën strukturat paralele dhe sot menaxhohet nga ndërmarrja shtetërore "Ibër-Lepenc".
- **Çarmatimi i barrikadave:** Sekuestruam alarmet dhe zmadhuesit e zërit për barrikadimin e rrugëve, si dhe kamerat ilegale që përgjonin zyrtarët tanë.
- **Liri e plotë e lëvizjes:** Ndërtuam 2 ura të reja mbi lumin Ibër në Mitrovicë, njërën për automjete dhe tjetrën për këmbësorë, të hapura në gusht dhe dhjetor të vitit 2025, me një investim prej **3 milionë euro** që e lidh jugun me veriun e Mitrovicës, ndërsa një urë e tretë është në ndërtim e sipër për të lidhur Zhabarin dhe Gushacin me Vidimriqin.
- **Rrjeti telekomunikues:** Modernizuam rrjetin për **4G+ dhe 5G** dhe shtuam **18 stacione** të reja, duke mundësuar për herë të parë shërbimet e Telekomit të Kosovës në komunat veriore, si dhe komunikimin e Policisë së Kosovës përmes tij, për më shumë siguri.

KAPITULLI I KATËRT

LOKALE

Komunat, shërbimet digjitale dhe reforma administrative. Shteti më afër qytetarit.

17 Fuqizimi i komunave 41

18 Mbështetja për komunitetet joshumicë 42

19 Digjitalizimi i shërbimeve 43

20 Reforma e administratës publike 45

17 Fuqizimi i komunave

867 mil € buxheti për komunat në vitin 2026, rritje prej 59% krahasuar me vitin 2021 kur ishte 547 milionë euro.

Granti i Përgjithshëm për Komuna

milionë euro



Shuma më e lartë e ndarë ndonjëherë për Grantin e Përgjithshëm për Komuna, **72%** më shumë se në vitin 2020.

Shtëpi për familjet në nevojë

260 SHTËPI TË NDËRTUARA, 13.8 MILIONË EURO

152 shtëpi të ndërtuara dhe 4 të rinovuara në komunat veriore, me vlerë 7.8 milionë euro

108 shtëpi për familje nga komunitetet joshumicë nëpër komuna të ndryshme, me vlerë 6 milionë euro

100 shtëpi të tjera do të ndërtohen në veri, sipas memorandumit të MAPL-së me Shoqatën "Jetimat e Ballkanit"



Punimet për ndërtimin e shtëpive për familjet përfituese.

Infrastrukturë, efiçiencë dhe e-qeverisje

- **288 projekte lokale:** investuam në projekte infrastrukturore në mbarë komunat, ku 236 prej tyre janë inicuar në këtë mandat.
- **E-Komuna dhe transparenca:** lancuam platformën E-Komuna dhe Kartën e Komunës së Gjelbër dhe të Qëndrueshme, si dhe u anëtarësuam në Open Government Partnership (OGP).
- **Lojërat Mesdhetare 2030:** mbi 10 komuna të Kosovës do të jenë mikpritëse të ngjarjes.

- **Zhvillimi i balancuar:** mbështetëm **976 projekte** përmes Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar, në vlerë 10.5 milionë euro, për 5 rajonet zhvillimore në vend.
- **Komunat për të rinjtë:** Nisëm programin e financuar nga Banka Botërore, me mbi **3 mijë të rinj** përfitues në 15 komuna.
- **Bashkëpunimi ndërkufitar:** Përmbyllëm **55 projekte** në kuadër të IPA II me Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, dhe miratuam programet e reja IPA III në vlerë 25.2 milionë euro.

18 Mbështetja për komunitetet joshumicë

rreth 600 grante për komunitetet joshumicë, në vlerë afër 6 milionë euro.

mbi 170
shtëpi të ndërtuara e të rinovuara për të siguruar kthim të qëndrueshëm dhe integrim për komunitetet joshumicë, në vlerë 5.76 milionë euro

34
apartamente të reja për familjet që kanë jetuar në qendra kolektive, në vlerë 2.6 milionë euro, me bashkëfinancim të Bashkimit Evropian

1,767
familje të ndihmuara: 364 me material ndërtimor, 516 me mobilie e teknikë të bardhë, 887 me pako ushqimore (gjithsej 1.22 milionë euro)

Ndarja sipas granteve		afër 6 mil €
226	Fermerë	2 milionë €
224	Ndërmarrës të rinj	2 milionë €
147	Organizata joqeveritare	1.7 milionë €

- **Punësimi:** Themeluam Grupin Ndërinstitucional për Promovimin e Punësimit të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve, përmes të cilit numri i vendeve të punës të siguruara për këto komunitete nga Agjencia për Punësim u rrit për **31%** (2022–2023).
- **Qendrat mësimore:** Ndamë **mbi 1 milion euro** për qendrat mësimore të fëmijëve romë, ashkalinj dhe egjiptianë, nga viti 2021 në 2026. Vetëm për vitin shkollor 2026/2027 ndamë **370 mijë euro** për 10 organizata që menaxhojnë 54 qendra mësimore, me rreth 2,630 fëmijë nga klasa e parë deri në të nëntën.
- **Financimi i aktiviteteve:** Mbështetëm **400 projekte** në edukim, kulturë, sport, shëndetësi dhe manifestime fetare në vlerë prej 1.4 milionë euro.
- **Mbrojtja nga martesat e hershme:** Themeluam Grupin Ndërinstitucional kundër Martesave të Hershme në Komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe krijuam mekanizmin për raportimin konfidencial të rasteve të tilla.
- **Arsimi dhe bursat:** Ndamë rreth **2,000 bursa** në vlerë 625 mijë euro për nxënësit romë, ashkalinj dhe egjiptianë në shkollat e mesme, shumica vajza.
- **Kadetët e Policisë:** Gjatë mandatit të Qeverisë Kurti 2 diplomuan 7 gjenerata me gjithsej **2,731 kadetë** policorë, prej tyre **363 ose 13.3%** nga komunitetet joshumicë: 208 serbë, 86 boshnjakë, 23 turq, 20 egjiptianë, 13 ashkali, 9 romë, 3 goranë dhe 1 çerkez.
- **Verifikimi i diplomave:** Rifilluam verifikimin e diplomave të Universitetit të Mitrovicës së veriut; tani **590 persona** me këto diploma mund të punësohen në institucionet publike, dhe nisëm verifikimin e diplomave të shkollave të mesme që mësimin e mbajnë në gjuhën serbe.

19 Digjitalizimi i shërbimeve

320 shërbime elektronike të lansuara në platformën e-Kosova, prej të cilave asnjë nuk ekzistonte më parë.

730
shërbime qendrore dhe lokale të thjeshtësuara përmes procesit të zvogëlimit të barrës administrative

1.1 milion
përdorues të regjistruar në platformën e-Kosova

9.8 mil €
miratimi i strategjisë së sigurisë kibernetike, me investim 3-vjeçar nga Qeveria dhe partnerët

Transaksione në e-Kosova
milionë transaksione
+135% rritje për 3 vite



Reformat në zhvillim e sipër

SHËRBIMET

- Ofrimi i shërbimeve të integruara bazuar në ngjarje jetësore (ndërrimi i vendbanimit, hapja e biznesit)
- Pilotimi i qendrave fizike të integruara të shërbimeve

PLATFORMAT

- e-Kosova 2.0, me funksionalitete të bazuara në inteligjencë artificiale
- Platforma mbarëqeveritare Whole-of-Government (WoG) dhe Korniza Nacionale e Interoperabilitetit
- Platforma kombëtare e Identifikimit Elektronik (eID) dhe kuleta digjitale

INFRASTRUKTURA DHE SIGURIA

- Implementimi i teknologjisë cloud në infrastrukturën digjitale qeveritare
- Modernizimi i rrjetit qeveritar

Vlerësimi ndërkombëtar

- **Raporti SIGMA 2024 (iniciativë e përbashkët e BE-së dhe OECD-së):** te ofrimi i shërbimeve dhe digjitalizimi Kosova është dukshëm mbi mesataren e Ballkanit Perëndimor, nga vendi i fundit në rajon që ishte në vitin 2021.
- **Indeksi GTMI i Bankës Botërore:** avancuam nga grupi C i vendeve me fokus të kufizuar në qeverisje digjitale, në grupin A të vendeve lidere.

- **Avancimi ndërkombëtar:** U anëtarësuam në Global Forum for Cyber Expertise (GFCE) dhe u bëmë pjesë e procesit Pall Mall, aleancës së vendeve demokratike që adreson përhapjen e teknologjive komerciale për ndërhyrje kibernetike.
- **Korniza ligjore:** Miratuam Ligjin për sigurinë kibernetike dhe Ligjin për identifikimin elektronik e shërbimet e besuara, futëm krimet kibernetike në Kodin Penal dhe miratuam Agjendën Digjitale 2030.

Çfarë ofron e-Kosova?

DOKUMENTE

- Certifikatat e lindjes, vdekjes e martesës
- Certifikatat e pronësisë dhe kadastra
- Dënimet penale dhe historia kriminale

FAMILJA DHE SHËNDETI

- Aplikimi për shtesat për fëmijë dhe lehona
- Zgjedhja e mjekut familjar
- Pasaporta elektronike e vaksinimit

PAGESA DHE PROCEDURA

- Faturat e ujit, energjisë e mbeturinave
- Tatimi në pronë dhe gjobat e trafikut
- Patentshoferi dhe regjistrimi i veturës

Dhe shumë e shumë shërbime të tjera, nga vula apostile te licencimet profesionale. Shërbimet me pagesë paguhen drejtpërdrejt në e-Kosova.

- **e-Kosova ka edhe aplikacionin e vet mobil, për iOS dhe Android.**

Sporteli virtual: kategoritë e shërbimeve

231 shërbime në **31** kategori

në ekosova.rks-gov.net/Services

Gjendja civile 16 shërbime	**Familja** 8 shërbime	**Tatimet** 3 shërbime
Arsimi 45 shërbime	**Shëndetësia** 7 shërbime	**Automjeti** 8 shërbime
Policia 4 shërbime	**Prona** 15 shërbime	**Gjyqësori** 5 shërbime
Komunalitë 13 shërbime	**Adresa** 2 shërbime	**e-Komuna** 7 shërbime
Grante dhe subvencione 1 shërbim	**Kontributet dhe pensioni** 1 shërbim	**Puna** 9 shërbime
Financat 2 shërbime	**Thesari** 2 shërbime	**Biznesi** 15 shërbime
Bujqësia 3 shërbime	**Profesionet e lira** 8 shërbime	**Licencimet** 13 shërbime
Auditorët ligjorë 6 shërbime	**Shërbimet konsulore** 2 shërbime	**Lejeqëndrim** 3 shërbime
Inspektoratet 1 shërbim	**Karta Rinore Evropiane** 1 shërbim	**Fondi i Sigurisë** 5 shërbime
Banderolat 1 shërbim	**Posta** 1 shërbim	**Autoshkolla** 22 shërbime
Nënshkrimi digjital 2 shërbime		

Në pilotim janë edhe shërbimet e integruara për ngjarjen jetësore të lindjes së fëmijës.

20 Reforma e administratës publike

70% e të rekrutuarve në shërbimin civil gjatë vitit 2025 ishin nën moshën 40-vjeçare.

60%

e të rekrutuarve gjatë vitit 2025 janë gra dhe vajza

90%

e aplikantëve në pozitat civile gjatë vitit 2025 ishin nga jashtë shërbimit civil, prej tyre 77% tashmë të punësuar

Gratë në administratën publike

NIVELET MË TË LARTA DERI TANI

42%
pjesëmarrja e grave në administratën publike

37%
përfaqësimi i grave në ministri dhe agjenci ekzekutive

33%
të pozitave drejtuese në institucione publike i mbajnë gratë

SIPAS NIVELIT DREJTUES

37.2% udhëheqëse të divizioneve e sektorëve

21.7% drejtoresha të departamenteve

23.2% sekretare të përgjithshme dhe drejtoresha ekzekutive

- **Ligji për Zyrtarët Publikë dhe Ligji për Pagat:** Hapëm administratën, rritëm efikasitetin dhe e kthyem besimin e qytetarëve përmes rekrutimeve meritore.
- **Racionalizimi i strukturës:** Riorganizuam agjencitë dhe strukturën e administratës për të eliminuar dyfishimet.
- **Regjistrimi i popullsisë:** Pas 13 vjetësh, në vitin 2024 Agjencia e Statistikave të Kosovës e realizoi regjistrimin e popullsisë (ReKos2024), të parin që nga viti 2011.
- **Patentshoferët jashtë vendit:** Nënshkruam marrëveshje për njohje të ndërsjellë të patentshoferëve me Gjermaninë, Italinë, Kroacinë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe.

KAPITULLI I PESTË

KOMBËTARE

Lugina, Shqipëria dhe mërgata. Kombi përtej kufijve administrativë dhe lidhja strategjike mbarëshqiptare.

21 Mbështetja për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin 47

22 Integrimi strategjik Kosovë–Shqipëri 48

23 Mërgata dhe përfshirja e saj në zhvillim 50

21 Mbështetja për Preshevën, Medvegjën dhe Bujanocin

4 mil € mbështetje buxhetore në vitin 2025.


1,234
bursa dhe ndihma financiare të ndara gjatë vitit 2024 për studentë e nxënës

756
bursa për studentët e Luginës në vitin 2025 (të gjithë studentët përfituan pa përjashtim)

580 mijë €
për ndërtimin e Shkollës së Muzikës dhe Muzeut të Preshevës, për herë të parë

Mbështetja buxhetore për Luginën

milionë euro



Sigurimi i librave shkollorë dhe parashkollorë në gjuhën shqipe për nxënësit shqiptarë në Luginë, çdo vit

2022	2023	2024	2025
4,010	3,986	3,708	3,650

Lehtësira dhe zëri i Luginës

- **Shtetësia e Kosovës:** Me miratimin e Ligjit të ri për Shtetësinë e Kosovës (Nr. 10/L-023), shqiptarëve të Luginës u mundësohet fitimi i shtetësisë së Kosovës përmes procedurave të thjeshtësuara, lirimit nga testi i gjuhës, dhe pa e humbur shtetësinë e tyre ekzistuese.
- **Mjekët specializantë:** Subvencionuam plotësisht shkollimin e 55 specializantëve nga Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi në vitin 2025, në vlerë rreth 316 mijë euro.
- **Zëri i Luginës në botë:** Mbështetëm financiarisht fushatat e përfaqësuesve shqiptarë në ShBA, Parlamentin Evropian, Këshillin e Evropës dhe Gjermani, në vitet 2023, 2024 dhe 2025.

- **Mbështetje për bujqit:** Ndamë **1 milion euro** për bujqit e Luginës për vitin 2024, mjete të cilat Serbia i bllokoi me mekanizma administrativë.
- **Bashkëpunimi me Këshillin Kombëtar Shqiptar:** Në vitin 2022 nënshkruam memorandumin e bashkëpunimit, dhe përmes tij deri tash kemi mbështetur **75 projekte** e nisma në Luginë.
- **Solidariteti në kriza:** Ndamë **gjysmë milioni euro** për përballjen e 3 komunave me pandeminë, si dhe 100 mijë euro për rimëkëmbjen e Preshevës nga vërshimet.

22 Integrimi strategjik Kosovë–Shqipëri

58 marrëveshje dypalëshe të nënshkruara përmes 2 mbledhjeve të përbashkëta qeveritare.



Mbledhja e përbashkët e dy qeverive, e Shqipërisë dhe e Kosovës, 26 nëntor 2021, Elbasan.

16
projekte të përbashkëta kërkimore me Shqipërinë, secili projekt nga 10 mijë euro

mbi 440 mil €
shkëmbime tregtare me Shqipërinë në vitin 2023, nga 300 milionë euro sa ishin në vitin 2020

4.4 mil €
kostoja e projektit madhor kombëtar "Enciklopedia Shqiptare", që po e bashkëfinancojmë

Një gjuhë, një kulturë, një komb

- **Një abetare e përbashkët:** tash e 4 vjet klasat e para në Kosovë e Shqipëri mësojnë shqipen me të njëjtën abetare.
- **Arti dhe trashëgimia:** krijuam Fondin e Përbashkët për projektet teatrore dhe organizuam festivalin mbarëkombëtar "Moisiu".
- **Fëmijët në mërgatë:** është bërë teksti shkollor Niveli I, II dhe III "Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare" për nxënësit e diasporës.
- **Studentët:** 30 bursa të ndërsjella në vit akademik, nga 1,000 euro, gjithsej 30 mijë euro.
- **Dija e përbashkët:** njohja e ndërsjellë e diplomave.

- **Zonat kufitare:** Hapëm **26 vendkalime** të reja për mbi 200 mijë banorë të zonave kufitare dhe mundësuam shërbime mjekësore për ta në spitalet e Kukësit, Gjakovës dhe Prizrenit.
- **Të drejta për qytetarët:** Hoqëm kërkesën për vulë apostile, lehtësuam lejeqëndrimin e përkohshëm dhe mundësuam përfitimin e pensioneve të pleqërisë me njohjen e periudhave të kontributeve në të dy vendet.

Energjia, infrastruktura dhe sporti

- **Tregu i përbashkët energjetik:** themeluam Bursën Shqiptare të Energjisë Shqipëri–Kosovë, ALPEX, dhe lidhëm tregun brenda ditës dhe një ditë para me Shqipërinë përmes saj.
- **Terminali i gazit natyror të lëngshëm (LNG) në Vlorë:** Në qershor 2022 nënshkruam memorandumin me Shqipërinë për zhvillimin e terminalit, si bashkëpunim strategjik për diversifikimin e burimeve dhe sigurinë energjetike. Kjo hap rrugën që Kosova të jetë aksionare në termocentralin me gaz në Vlorë, ose të sigurojë kontrata afatgjata për energji elektrike dhe sasi të kufizuara gazi.
- **Hekurudha Prishtinë–Durrës:** Nënshkruam marrëveshjen për ndërtimin e hekurudhës, përfshirë segmentin Gjakovë–Shkodër, dhe më 1 mars 2025 u prezantua studimi i fizibilitetit. Ky është projekti më i madh infrastrukturor kombëtar, që do t'i lidhë ekonomitë e dy vendeve dhe do t'i afrojë qytetarët tanë.
- **Lojërat Mesdhetare 2030:** bashkëpunim për kandidaturën e suksesshme të Kosovës për organizimin e tyre.
- **Kampionati Evropian i volejbollit:** e bashkëorganizuam me sukses për grupmoshat U16 të vajzave.

- **Partneri kryesor tregtar:** Eksportet drejt Shqipërisë arritën **160 milionë euro** në vitin 2025, ose 17% të eksporteve tona, ndërsa importet 286.8 milionë euro, ose 4% të importeve.
- **Nga letra te zbatimi:** Hapëm 2 zyra doganore në Durrës dhe Porto Romano dhe reduktuam skanimin e dyfishtë nga 100% në **10%**.
- **Korridoret ajrore:** Hapëm korridore të reja ajrore për fluturime komerciale, duke i shkurtuar trajektoret për dhe nga Kosova për **8 deri 12 minuta** dhe distancën për 90 deri 110 kilometra.

23 Mërgata dhe përfshirja e saj në zhvillim

10.4 mil € vlera e bonove të diasporës, të emetuara që në vitin e parë të mandatit tonë.

PLATFORMAT E REJA PËR NDËRLIDHJE DHE INVESTIME

Iniciuam tre platforma online: **"Shijo Kosovën"**, **"Made in Kosova"** dhe **"Diplo365"**, me qëllim të avancimit të angazhimit të diasporës dhe promovimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Përmes këtyre platformave janë ofruar informacione të detajuara mbi potencialin ekonomik dhe tregtar të vendit, programe të ndryshme kulturore, sportive dhe edukative për diasporën, si dhe prezantimi i ngjarjeve historike dhe personaliteteve të rëndësishme që kanë kontribuar në zhvillimin politik, kulturor dhe diplomatik të Kosovës. Këto iniciativa synojnë të lehtësojnë qasjen e diasporës në resurset shtetërore dhe të forcojnë lidhjet institucionale mes Kosovës dhe bashkatdhetarëve.

"Java e Kulturës Jashtë Vendit": lansuam programin që e prezanton kulturën dhe artin tonë në nivel ndërkombëtar, përmes misioneve tona diplomatike dhe konsullore.



Lansimi i edicionit vjetor të platformës "Shijo Kosovën", korrik 2024.



Lansimi i platformës "Made in Kosova", maj 2024.



"Java e Kulturës Jashtë Vendit" në Portugali.

3 mil €
ndamë për Masën 2.2, që i mbështet bizneset e mërgatës të kthehen e të investojnë në Kosovë, përmes Dritares për Investimet e Diasporës

4 mil €
për policën kufitare, kartonin e gjelbër, të bashkatdhetarëve në vitin 2025, viti i katërt i nismës

20,968
komplete mësimore të dërguara në diasporë në dy vitet e fundit shkollore, 2024/2025 dhe 2025/2026

mbi 200
takime me mërgatën përmes platformës "Dialogu me Mërgatën", e zhvilluar në 20 lokacione jashtë vendit

DIPLOMACIA, SHKENCA DHE BURSAT

Ulpiana Forum: krijuam forumin ndërkombëtar që synon ta bëjë Kosovën qendër të diskutimeve për diplomacinë e mërgatës dhe migrimin, dhe të nxisë një rrjet ndërkombëtar bashkëpunimi në këto fusha.

Shkolla për Diplomacinë e Diasporës: krijuam platformën ku diplomatët tanë njihen me modelin e angazhimit të mërgatës, të zhvilluar nga Akademia Diplomatike e MPJD-së me partnerë vendorë e ndërkombëtarë.

Diaspora Shkencore dhe "Diaspora Talks": organizuam Konferencën e Diasporës Shkencore dhe mbështetëm bashkëpunime shkencore me Universitetin e Prishtinës e universitete ndërkombëtare.

Kosovo Scholarship Fund: lansuam programin e bursave për studentët ndërkombëtarë që zgjedhin të studiojnë në Universitetin e Prishtinës.

- **Rruga më e lehtë drejt shtetësisë:** Me miratimin e Ligjit të ri për Shtetësinë e Kosovës (Nr. 10/L-023), pjesëtarëve të diasporës dhe pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë u mundësohet fitimi i shtetësisë së Kosovës përmes procedurave të thjeshtësuara dhe pa e humbur shtetësinë e tyre ekzistuese.
- **Votimi:** Me miratimin e Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, mërgata votoi për herë të parë në ambasada e konsullata, në zgjedhjet e vitit **2025**, dhe e lansuam regjistrimin online përmes platformës e-Diaspora.
- **Gjuha shqipe në botë:** Për herë të parë mbajtëm punëtori me mësuesit e gjuhës shqipe në Zvicër, Gjermani dhe Austri, për mësimin plotësues.

Mësimi, kultura dhe rinia shqiptare jashtë vendit

MBËSHTETUR NGA QEVERIA

	2025	2026		2025	2026
Seminare me mësimdhënës	5	6	Aktivitete sportive me klube	1	2
Vizita studimore të nxënësve	3	3	Forumi Shkencor për Diasporën	1	1
Festivale të filmit shqip	2	4	Organizime me këshillat e shoqatave	10	10+

KAPITULLI I GJASHTË

NDËRKOMBËTARE

Rruga evropiane, politika e jashtme dhe perceptimi global. Nga vendi i fundit në lider rajonal.

24	Progresi drejt Bashkimit Evropian	53
25	Politika e jashtme dhe anëtarësimet	54
26	Lartësimi i imazhit ndërkombëtar	56

24 Progresi drejt Bashkimit Evropian

35 fusha me progres në Raportin e Progresit të vitit 2025, nga gjithsej 38 fusha që i mat Komisioni Evropian.

Avancimi në faza të përgatitjes

Në **14 fusha** u ngritëm një shkallë në raport me standardet dhe acquis-në e Bashkimit Evropian:

Lufta kundër korrupsionit
fazë e hershme → mes fazës së hershme dhe një niveli të caktuar përgatitjeje

Lufta kundër krimit të organizuar
fazë e hershme → mes fazës së hershme dhe një niveli të caktuar përgatitjeje

Drejtësia, liritë dhe siguria
fazë e hershme/nivel i caktuar → nivel i caktuar përgatitjeje

Ekonomia e tregut funksionale
fazë e hershme/nivel i caktuar → nivel i caktuar përgatitjeje

Përballja me presionet konkurruese dhe forcat e tregut
fazë e hershme → mes fazës së hershme dhe një niveli të caktuar përgatitjeje

Politikat për konkurrencën
fazë e hershme/nivel i caktuar → nivel i caktuar përgatitjeje

Lëvizja e lirë e mallrave
nivel i caktuar përgatitjeje → nivel i caktuar/mesatarisht e përgatitur

Lëvizja e lirë e kapitalit
nivel i caktuar përgatitjeje → mesatarisht e përgatitur

Legjislacioni për pronësinë intelektuale
nivel i caktuar përgatitjeje → mesatarisht e përgatitur

Siguria ushqimore, veterinaria dhe politikat fitosanitare
nivel i caktuar përgatitjeje → mesatarisht e përgatitur

Politikat sociale dhe të punësimit
fazë e hershme → nivel i caktuar përgatitjeje

Arsimi dhe kultura
fazë e hershme → nivel i caktuar përgatitjeje

Politikat e transportit
fazë e hershme/nivel i caktuar → nivel i caktuar përgatitjeje

Politikat e jashtme
fazë e hershme → nivel i caktuar përgatitjeje

- **Aplikimi për anëtarësim:** Kosova e dorëzoi zyrtarisht aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian më **15 dhjetor 2022**.

  Aplikimin e dorëzoi Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në Pragë, te ministri për Çështje Evropiane, Mikuláš Bek, në emër të vendit që mbante Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian.



- **Qëndrueshmëria e reformave:** Gjatë gjithë mandatit asnjë fushë e vetme nuk shënoi regres.
- **Liberalizimi i vizave:** Që nga **1 janari 2024** qytetarët e Kosovës udhëtojnë pa viza në zonën Shengen.
- **Evropa Digjitale:** U bëmë pjesë e programit të Bashkimit Evropian për transformim digjital, dhe në vitin 2024 përfituam për herë të parë mbi **300 mijë euro** si partner në Qendrën Evropiane të Inovacionit Digjital në ITP.

25 Politika e jashtme dhe anëtarësimet

vendi 63 renditja e pasaportës sonë në botë, nga vendi 108 në vitin 2021.

27
anëtarësime e angazhime në organizata, mekanizma dhe iniciativa ndërkombëtare e rajonale, përfshirë ato sportive

150
marrëveshje ndërkombëtare, memorandume, protokolle dhe marrëveshje ndërshtetërore të finalizuara

mbi 600
takime zyrtare jashtë vendit dhe 70 vizita të delegacioneve tona të larta me bashkëpunëtorë ndërkombëtarë

mbi 50
konferenca ndërkombëtare ku përfaqësuesit tanë prezantuan prioritetet e vendit

MARRËVESHJET KRYESORE

45
marrëveshje për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim financiar me Bankën Botërore, BE-në dhe BERZH-in

28
marrëveshje për lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve, njohjen e dokumenteve dhe heqjen e vizave

22
marrëveshje për mbrojtjen e mjedisit dhe energjinë e ripërtëritshme

23
marrëveshje në siguri dhe drejtësi, kundër krimit të organizuar dhe për ekstradimin

32
marrëveshje në kulturë, arsim dhe teknologji

Njohjet, lëvizja e lirë dhe prania jonë diplomatike

NJOHJE TË REJA

- Kenia
- Sudani
- Siria
- Bahamet

PRANIMI I PASAPORTËS

- Spanja
- Armenia

UDHËTIM PA VIZA

- Emiratet e Bashkuara Arabe
- Tajvani
- Brunei
- Izraeli
- Tajlanda

MISIONE TË REJA

- Misioni i Posaçëm, Selia e Shenjtë
- Konsullata e Përgjithshme, Varshavë
- Ambasada, Bogota
- Ambasada, Kuala Lumpur
- Zyra e Kosovës në Athinë, me status të ngritur
- Në ardhje: Konsullata e Përgjithshme, Teksas

Avancimi në organizata dhe aleanca

KËSHILLI I EVROPËS

Aplikuam dhe kaluam me sukses fazën e parë në Asamblenë Parlamentare (PACE) drejt anëtarësimit.

NATO

E avancuam statusin e Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s.

U ANËTARËSUAM NË ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE SI:

- International Commission on Missing Persons (ICMP)
- Open Government Partnership (OGP)
- International Conference of Information Commissioners (ICIC)
- Bureau International des Expositions (BIE)
- International Religious Freedom or Belief Alliance

- **Blerja e ambasadave:** Për herë të parë blemë objektet tona diplomatike, në Uashington, Londër, Zagreb, Senegal, Strasburg dhe Otavë, kurse po i finalizojmë edhe blerjet në Berlin, Paris, Romë dhe Ankara. Ky proces shënon një ndryshim radikal në sigurimin e hapësirave të qëndrueshme për përfaqësimin diplomatik të Kosovës.
- **Rreshtimi me aleatët:** Hyri në fuqi Ligji për Zbatimin e Sanksioneve Ndërkombëtare të Shënjestruara.
- **Solidariteti ndërkombëtar:** Pranuam 1,961 refugjatë dhe 5 gazetarë afganë, dhe strehuam e u ofruam punë 19 gazetarëve ukrainas.
- **Mbrojtja e të drejtave:** Miratuam Deklaratën kundër ndalimit arbitrar në marrëdhëniet shtet me shtet.

Diplomacia e Kosovës në veprim

Konsultime politike, takime dhe marrëveshje dypalëshe me shtete partnere, gjatë mandatit tonë.



Kosova dhe Portugalia nënshkruajnë disa marrëveshje dypalëshe.



Kosova dhe Austria thellojnë bashkëpunimin dypalësh dhe mbajnë konsultime politike në Vjenë.

26 Lartësimi i imazhit ndërkombëtar

28 vende ngritje në indeksin e perceptimit të korrupsionit, sipas raportit të Transparency International, nga vendi 104 (2020) në 76 (2025), progres historik gjatë mandatit tonë.

Mirëqenia e qytetarëve

% e popullsisë që shprehej se jeta e tyre po ecte mirë

GALLUP



Ky ishte përmirësimi më i lartë i mirëqenies në botë, sipas matjeve globale të Gallup-it.

Si na sheh bota?

SIPAS RAPORTEVE NDËRKOMBËTARE

1	në Evropë për ligjin dhe rendin, dhe e treta në botë	GALLUP 2025
1	në Ballkanin Perëndimor për demokraci elektorale, dhe e dyta për demokraci liberale	V-Dem
1	në Ballkanin Perëndimor për përmirësim në të drejtat politike dhe liritë civile, e dyta në Evropë dhe e treta në botë	FREEDOM HOUSE 2023
1	në Ballkanin Perëndimor për rritjen e grumbullimit të të hyrave	FONDI MONETAR NDËRKOMBËTAR (FMN) 2022
2	në Ballkanin Perëndimor për shtetin e së drejtës, dhe e 59-ta në botë	WORLD JUSTICE PROJECT 2025
16	në botë për lumturinë, sipas vlerësimeve të jetës 2023–2025	GALLUP 2026

- **Ku kryesojmë te shteti i së drejtës:** World Justice Project na rendit të parët në rajon në 4 nënfaktorë: kufizimet e pushtetit qendror, rendi dhe siguria, mungesa e korrupsionit dhe qeverisja e hapur.
- **Përparimi në indekset ndërkombëtare:**
  - **Liria e shtypit:** nga vendi 99 në vitin 2025 në vendin 84 në vitin 2026, sipas Reporterëve pa Kufij.
  - **Krimi i organizuar:** përparim për 34 vende që nga viti 2021, me nivelin më të ulët të kriminalitetit në Ballkanin Perëndimor.
  - **Të drejtat politike dhe liritë civile:** nga 54 pikë në vitin 2021 në 61 pikë në vitin 2026, sipas Freedom House.
- **Heqja e Kosovës nga lista e shteteve të brishta:** Banka Botërore dhe FMN-ja e hoqën Kosovën nga Lista e Shteteve në Situata të Brishta dhe Konflikti zyrtarisht në korrik të vitit 2025.

BILANCI I MANDATIT QEVERISËS
DHE KONSOLIDIMI I SHTETIT DEMOKRATIK

TË ARRITURAT KRYESORE TË QEVERISË KURTI 2

2021–2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister